

UNIVERSITETI "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
Departamenti: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit



Departamenti: AGROBIZNES

Studime Msc

PUNIM DIPLOME

**Ndikimi i granteve në rritjen e prodhimtarisë dhe punësueshmerisë në
sektorin e bujqësisë në rajonin e Ferizajt**

Mentor:

Prof.Dr. Muje Gjonbalaj

Kandidati:

Korab Hoxha

Mars, 2021, Ferizaj

Deklarata

Me anë të kësaj deklaratë, unë **Korab Hoxha**, deklaroj se punimi i kësaj teme diplome të nivelit bachelor, me titull *“Ndikimi i granteve në rritjen e prodhimit dhe punësueshmerisë në sektorin e bujqësisë në rajonin e Ferizajt”* është rezultat i punës studimore disa mujore dhe është bërë personalisht nga vetë unë.

Asnjë pjesë e këtij punimi nuk është marrë nga askush pa qenë e cituar sipas standarteve të pranuar. Ky punim studimi është ideuar dhe dizajnuar duke u bazuar nga burimet e cituara dheshfrytëzuar burimet e cekura në referenca dhe në literaturën e shënuar.

Gjithashtu e bëj të qartë se, në bazë të njohurive të mia, punimi im i diplomës nuk cenon të drejtat e asnjë autori, në asnjë rast. Dhe për të kundërt të saj, pranoj përgjegjësitë e mia të cilat do të më ngarkohen nga cilido komision që eventualisht do të shqyrtojë ndonjë rast ankese lidhur me përmbajtjen e punimit, dhe në të njëjtën kohë pranoj të vlerësohem në bazë të rregullores dhe statutit të Universitetit dhe ligjit mbi të drejtën e autorit.

Falënderim

Para së gjithash, rreshtat e parë të falenderimeve me shumë mirësi dhe respekt do ia dedikojë mentorit tim, shumë i nderuari Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj, urtësia dhe eksperiencia e të cilit më kanë shoqëruar jo vetëm gjatë kohës së hartimit të punimit por, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Këshillat dhe udhëzimet e tij metodike dhe profesionale i kam konsideruar si tejet të nevojshme në përballjen me barrierat dhe peripecitë e rrugëtimit tim të formimit profesional .Përkushtimi, vullneti ndaj punës dhe mbështetja e tij morale më kanë inkurajuar vazhdimisht dhe e kanë bërë më të lehtë çdo lloj sfide profesionale dhe jetësore.

Do të doja të ndaja mirënjohjen time të gjithë profesorëve të stafit akademik të drejtimin të Agrobiznesit, të cilën në mënyrë kontinuele më kanë ofruar përkrahjen e tyre dhe më kanë shty të progresoj para. Kam mbajtur shënim për gjithë këshillat dhe indikacionet e tyre të vlefshme.

Përmbledhje

Qëllimi i punimit tonë është të paraqes rolin dhe rëndësinë e masave mbështetëse të politikave bujqësore, me theks të veçantë të granteve investuese në zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale në përgjithësi.

Objektivat e punimit janë si më poshtë:

- të analizojë rolin dhe rëndësinë e granteve investuese në zhvillimin e sektorit bujqësorë në vendin tonë, Kosovë.
- cila është përvoja e implementimit të kësaj mase të politikës bujqësore në Kosovë.
- të prezantojë gjendjen aktuale të sektorëve bujqësorë në Kosovë, barrierat mbështetëse financiare nëpër të cilat kalon dhe influenca pozitive që kanë pasur masat e politikës bujqësore si pagesat direkte dhe grantet investuese në zhvillimin e zonave rurale në përgjithësi.
- të identifikojë çështjet e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së si dhe rrugën që duhet ndjekur Kosova për të dinamizuar zhvillimin e bujqësisë në vend.

Për realizimin e suksesshëm të këtij punimi janë shfrytëzuar të dhëna konçize dhe koherente me gjendjen aktuale të bujqësisë së vendit tonë, duke u mbështetur në materiale, raporte vjetore, punimeve shkencore dhe statistikave të ofruara nga institucionet e ndryshme si ato të Ministrisë së Bujqësisë, pastaj të ASK-së, Ministrisë së Financave etj.

Në këtë studim neve kemi arritë në një konkludim se Kosova si shtet i ri, me një traditë shtetërore vetëm trembëdhjetë vjeqare, dhe përkundër përcaktimeve me dokumentet dhe aktet juridike më të larta të vendit si një shoqëri demokratike, për ekonomi të hapur dhe tregëti të lirë, ajo prapëseprapë ka nevojë shumë të madhe për një zhvillim më të hovshëm ekonomik, integritime edhe më të fuqishme në institucionet ndërkombëtare politike, ekonomike dhe tregëtare. Ajo ka trashëguar shumë probleme të cilat janë grumbulluar gjatë dekadave të fundit. Ato rezultojnë në shfrytëzim të pakontrolluar të resurseve natyrore, dendësi të lartë të popullsisë, urbanizim të shpërndarë, veprimtari ekonomike industriale, përfshire mineralet dhe industrinë përpunuese.

Bujqësia e Kosovës dita ditës po udhëhiqet drejt një zhvillimi më të lartë, kjo falë ndryshimeve të strategjive punuese, kuadrove profesionale të politikbërësve, pastaj të udhëheqjes së institucioneve që kanë peshë ndikimi në aktivitetet e zonave rurale.

Grantet investuese kanë ndikuar për të mirë në ngritje të kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese në nivel rural dhe mbarëkombëtar më pastaj, edhe pse niveli i arrirë nuk është njëjtë me atë të planifikuar dhe të dëshiruar, mbase mund të vije si rezultat i keqmenagjimeve të strukturave në njërën anë, dhe në anën tjetër vije si rezultat i mos përdorimit të librit të kontabilitetit në ferme, në këtë mënyrë Ministria nuk ka mundësi të identifikoj sa është prodhimtaria bujqësore në tregun e brendshëm dhe nëse mbështetja financiare përmes granteve dhe subvencioneve është duke dhënë rezultat apo nëse duhet rishikuar mënyra e mbështetjes. Andaj, në mungesë të këtyre mekanizmave dhe metodave adekuate, Ministria nuk ka informata cilësore me rastin e përgatitjes së programit.

Ne rekomandojmë që të rishiqohen vazhdimisht strategjitë egzistuese sektoriale që kanë ndikim në bujqësi pas një analize të mirfilltë sektoriale në raport me potencialet dhe resurset e zonave rurale.

Studimi tregon që niveli i zhvillimit rural përbënë indikatorin kryesor që shfaq njëherish edhe shkallën ekonomike të vendit, dhe sugjeron që për një nivel më të dëshiruar është shumë e rëndësishme që politikbërësit bujqësorë të orientojnë objektivat e tyre drejt masave të programit të zhvillimit rural si të pagesave direkte dhe granteve investuese, të rritet buxheti i shtetit për bujqësi dhe po ashtu të hartohen dhe të funksionalizohen mekanizma të veçantë të matjes së suksesit të aplikimit të granteve që do iu shërbejnë fillimisht fermave e më pastaj edhe strukturave më të larta udhëheqëse.

Përmbajtja

Deklarata	2
Falënderim	3

Përmbledhje	3
Lista e tabelave.....	6
Lista e figurave	7
Lista e shkurtesave dhe akronimeve.....	8
1.1. Hyrje.....	9
1.2. Problemi i kërkimit / arsyeshmëria.....	11
1.3. Objektivat	12
1.4. Pytjet kërkimore/hipotezat.....	13
1.5. Organizimi i punimit	14
2. RISHIKIMI I LITERATURWS	15
2.1 Politikat agrare dhe roli i politikave në zhvillimin e bujqësisë në Kosovë	15
2.2 Plani për Zhvillim Rural dhe Bujqësorë 2014-2020.....	17
2.3 Politikat e Përbashkëta Bujqësore të BE-së	22
2.4 Reformat e politikës së përbashkët bujqësore evropiane	25
2.4.1 Vlerësimi përgjithshëm dhe rëndësia e granteve në Kosovë	28
2.5 Aspektet gjeografike, klimatike dhe demografike të Kosovës.....	34
2.5.1 Rajoni i Ferizajt.....	37
2.5.2 Përdorimi i tokës bujqësore	38
2.6 Historiku i bujqësisë	41
2.7 Gjendja aktuale në Bujqësi	43
2.7.1 Fuqitë dhe dobësitë e sektorit bujqësor dhe të zonave rurale	46
3. METODOLOGJIA DHE TE DHENAT E PERDORURA	48
4. DISKUTIMI I REZULTATEVE	51
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	59
5.1 Konkluzionet.....	59
5.2 Rekomandimet	60
Literatura.....	63

Lista e tabelave

<i>TABELA 1. PZHRB 2014-2020 BUXHETI TOTAL INDIKATIV PËR MASË.....</i>	<i>18</i>
--	-----------

TABELA 2. BUXHETI I PPB-SË 2014-2020 NË MILIARDË EURO.	28
TABELA 3. SHPENZIMET PËR BUJQËSI NGA MBPZHR DHE KOMUNAT.	31
TABELA 4. POPULLSIA REZIDENTE DHE EKONOMITË FAMILJARE PRIVATE.	35
TABELA 5. SHTATË RAJONET ADMINISTRATIVE TË KOSOVËS.	37
TABELA 6. SIPËRFAQJA E SHFRYTËZUAR E TOKËS BUJQËSORE 2015-2017, (HA).	39
TABELA 7. MADHËSIA E EKONOMIVE SIPAS SIPËRFAQES SË TOKËS SË PUNUESHME, 2017	40
TABELA 8. EKSPORT-IMPORT I PRODUKTEVE BUJQËSORE, NË 1000 EURO.	45
TABELA 9. EFEKTI I GRANTEVE	50
TABELA 10. NUMRI I PROJEKTEVE TË KONTRAKTUARA SIPAS MASËS, 2014-2018	51
TABELA 11. TREGUESIT E REZULTATEVE TË MASA 302	53
TABELA 12. REZULTATET KRYESORE TË LLOGARITJEVE BAZUAR NË TË DHËNAT E MBLEDHURA DHE TË DHËNAVE FADN	57

Lista e figurave

FIGURA 1. PLANI I SHPENZIMEVE TË MBPZHR PËR GRANTE DHE SUBVENCIONE PËR VITET 2016, 2017, 2018.....	30
FIGURA 2. SHPENZIMET E SHTATË KOMUNAVE PËR GRANTE DHE SUBVENCIONEVE PËR TRI VITE.	30
FIGURA 3. PLANI, MIRATIMI DHE APROVIMI PËR GRANTE PËR VITET 2016, 2017 DHE 2018.	32
FIGURA 4. PËRMBAJTJA E GRANTEVE DUKE PËRFSHIRË MASAT DHE NËN-MASAT E TYRE.	32

Lista e shkurtesave dhe akronimeve

AKMM - Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
AZHB - Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë
BE - Bashkimi Evropian
BPV - Bruto Produkti Vendor
BQK - Banka Qendrore e Kosovës
DAESB - Departamenti për Analiza ekonomike dhe Statistika Bujqësore
FAO - Organizata Botërore e Ushqimit
FADN - Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (the Farm Accountancy Data Network)
FBEZHR - Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural
FGBE - Fondi i Garantuar Bujqësor Evropian
Ha - Hektarë
IPARD - Instrumenti për Asistencë në Para-Anëtarësim për Zhvillim Rural
KE - Komisioni i Evropës
MBPZHR - Ministria e Bujqësisë Pyllëtarisë dhe Zhvillimit Rural
MF - Ministria e Financave
MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NIF - Numri i Identifikimit të Fermës
NJVP - Njësia Vjetore e Punës (eng. AWU)
OBT - Organizata Botërore e Tregtisë
OJQ - Organizatë jo-qeveritare
PPB -Politikat e Përbashkëta Bujqësore
PZHRB - Plani për Zhvillim Rural dhe Bujqësorë
SPSS -Programi Statistikorë për Shkenca Sociale
SWOT - Fuqitë DobësitëMundësitë dhe Kercnimet
USAID - Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Nderkombëtar
VBSH – Vlera Bruto e Shtuar (eng. GVA)
TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
TF - Tipi i Fermës
FADN - Farm Accountancy Data Network (Rrjeti i Kontabilitetit të të Dhenave në Ferm),

1.1. Hyrje

Zhvillimi rural është proces në të cilin njerëzit në viset rurale (individët, amvisëritë, komuniteti, fermerët etj.) i bashkojnë resurset e tyre për të përmirësuar kushtet jetësore dhe ato të punës. Përmes përmirësimit dhe rritjes së shkathhtësive të tyre, ata synojnë të rrisin kapacitetet e përgjithshme individuale dhe të organizatave të tyre komunitare, për të përmirësuar të ardhurat e tyre, shëndetin, edukimin, infrastrukturën dhe shërbimet tjera sociale. Së fundi, banorëve të zonave rurale u jipet mundësia që të kontribuojnë për lirinë civile, të menaxhojnë vetë-zhvillimin e tyre, me marrëdhënie të balancuara gjinore dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të ambienteve rurale (Raport, 2010).

Sektori i bujqësisë në Kosovë luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e mundësive në punësim dhe në krijimin e të ardhurave. Analiza SWOT për bujqësinë e Kosovës thekson zëvendësimin e importit dhe qasjen e lirë në tregun e BE-së, si mundësi e rëndësishme për përmirësimin e të ardhurave kombëtare dhe individuale nga bujqësia në Kosovë. Megjithatë, ky potencial do të realizohet vetëm nëse fermat janë të afta të konkurrojnë me çmimet e tregut në rajon dhe në BE (MBPZHR, 2017).

Në kushtet e vendit tonë sektori i ushqimit së bashku me atë të bujqësisë ka kapacitet të mjaftueshëm të kontribuojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, në zbutjen e varfërisë dhe në rritjen e sigurisë së ushqimit. Për avancimin dhe përmirësimin e situatës, politikat bujqësore janë të orientuara për rritjen e produktivitetit të qëndrueshëm bujqësor, duke përfshirë politikat që ndikojnë në mjedisin e biznesit bujqësor dhe mënyrën e shfrytëzimit të pasurive natyrore për të mbështetur transformimin strukturor dhe inovacionin në bujqësi. Për realizimin e aktiviteteve të parapara buxheti i ndarë për mbështetjen e sektorit të bujqësisë çdo vit ka shënuar rritje (MBPZHR, 2018).

Sektori i bujqësisë si aktivitet ekonomik shumë i rëndësishëm dhe strategjik për vendin tonë merr pjesë me **9%** të Bruto Produktit Vendor. Ndërsa në raport me gjithsej numrin e të punësuarve bujqësia merr pjesë me rreth **25%**, ku në këtë sektorë punojnë 362,700 persona (MBPZHR, 2018).

Ministria e Bujqësisë, viteve të fundit ka përkrahur sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural me subvencione dhe grante investive. Këto investime të ministrisë, përmes Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2019 janë planifikuar të jenë në vlerë prej 25,7 milionë euro, ndërsa investimet e ministrisë përmes pagesave direkte planifikohen të jenë rreth 25 milionë euro (MBPZHR, 2018).

Nga viti në vit është rritur numri i përfituesve të granteve investive, duke treguar se nga 403 përfitues sa ishte në vitin 2014, ky numër në vitin 2018 ka arritur në mbi 600 përfitues, gjë që dëshmon rritjen e mbështetjes së ministrisë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë (MBPZHR, 2018).

Kosova është në procesin e ristrukturimit të ekonomisë me synim të arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, Përmirësimi i njohurive mbi mundësinë dhe kufizimet e diverzifikimit të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës do të kontribuojë në zbutjen e varfërisë.

Bujqësia e Kosovës pra, është sektor në konsolidim i cili do të ndikojë në përmirësimin e kualitetit të jetesës në vendbanimet rurale dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Duke e ditur këtë fakt Qeveria e Kosovës ka treguar përkushtimin e saj për krijimin e parimeve të ekonomisë së qëndrueshme të tregut dhe ka qenë e vendosur që përmes granteve për zhvillim dhe Pagesave direkt të mbështet fermerët përmes skemave të qëndrueshme financiare.

Si rezultat i kësaj është shfaqur nevoja dhe interesimi për t'i hulumtuar efektet që kanë pasur përpjekjet institucionale për ta ndihmuar këtë sektor, i cili nëpërmjet politikave mbështetëse shumtë e ndara për të stimuluar përkrahjen e zhvillimit kanë tendencë të rritjes në formë kontinuele.

Më konkretisht, qëllimi i këtij hulumtimi është që të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i rezultateve të arritura të PBZHR, e në veçanti, ndikimi i granteve investuese në zhvillimin e përgjithshëm bujqësor të Kosovës.

Duke u mbështetur fuqishëm në gjithë çfarë u potencua më lartë, në mënyrë paralele ne vejmë në pah rolin dhe rëndësinë e sektorit të bujqësisë në ekonominë e vendit tonë, Kosovë. Po ashtu, identifikojmë politikat agrare kombëtare me masat përkatëse, të cilat përbëjnë zingjirin e

zhvillimit rural, që në formë lineare inicon zhvillimin progresiv të vendit, dhe e gjithë kjo analizë nxitet të detajizohet në kapitujt e këtij punimi.

1.2. Problemi i kërkimit / arsyeshmëria

Analiza e aftësisë konkurruese e bujqësisë së Kosovës tregon që aktualisht vetëm një pjesë shumë e vogël e fermave mund të konkurrojnë në tregun rajonal, të BE-së dhe atë ndërkombëtar. Shkaktarët kryesorë të kësaj aftësie të ulët konkurruese janë përmasat e vogla të shumicës së bizneseve bujqësore, fragmentimi i tokës së tyre, ndërtesat dhe pajisjet e vjetra, mungesa e mjeteve financiare për investime dhe niveli i ulët i njohurive lidhur me teknologjinë bashkëkohore të prodhimit (MBPZHR, 2017).

Një pjesë e madhe e fermave janë aq të vogla sa pothuaj i tërë prodhimi i tyre konsumohet drejtpërdrejt nga familja në fermë. Kështu që ka nevojë për përkrahje të investimeve në asetet fizike të fermave që kanë orientim komercial dhe janë në gjendje të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme. Po ashtu duket e arsyeshme që të nxitet edhe bashkëpunimi horizontal ndërmjet bujqve në formën e bashkëpunimit të prodhuesve, i cili mund ta ndërtojë bazën për organizatat e mëvonshme prodhuese, ose shoqatat e prodhuesve, por edhe për integrimin vertikal të bujqve, për shembull në hallkat e tregut përmes kontratave të furnizimit (Zymeri, S. Thaqi, F. Hoxha, A., 2019).

Problem i kërkimit tonë është i lidhur me dy të vërteta që përplasen kontekstualisht me njëra tjetrën. E para ka të bëjë me tendencën e granteve investuese që të japin efekt pozitiv në rritjen e prodhimit dhe punësueshmërisë në sektorin e bujqësisë dhe mirëqenien e zonave rurale në përgjithësi dhe këtë e dëshmon rritja e shumave mbështetëse për fermerët përfitues çdo vit e më tepër, ndërsa aspekti tjetër që i kundërvihet është pikërisht rënia e pjesëmarrjes së bujqësisë në Bruto Produktin Vendor në vitin e fundit dhe poashtu, bilanci tregtar negativ përbën një tjetër element kyç dhe mjaftë shqetësues, duke përfshirë këtu edhe pambulueshmërinë e kërkesave të tregut për produkte bujqësore në nivel kombëtar.

Arsyeja e hulumtimit tonë është të informojë lexuesin mbi mjetet dhe akterët që ndikojnë dhe kontribuojnë në mënyrë direkte apo edhe të tërthortë në ngritjen e potencialeve të sektorit bujqësorë duke hartuar politika të mirëfillta në përkrahje të fermerëve kosovarë, përmendim

këtu me theks të veçantë plan-programet për bujqësi dhe zhvillim rural me masat gjegjëse si pagesat direkte dhe grantet investuese.

Në mes të tjerash është e rëndësishme të ritheksohet fakti se fermat prodhuese të çfarëdo lloji madhësie përbëjnë në vete thelbin e zhvillimit të një vendi pasi janë ato që sigurojnë ushqim të mjaftueshëm për popullatën, pastaj hapin vende të punës, gjenerojnë të ardhura, krijojnë mundësi të reja zhvillimi dhe përbëjnë hallkën e parë të zingjirit ekonomik, prandaj është tejet e rëndësishme hartimi i duhur i politikave bujqësore dhe vije në shprehje masa e granteve që përbëjnë përkrahjen investuese, dhe po ashtu punimi vë në pah rëndësinë e matjes së performancës së kësaj mase në veqanti, në bujqësinë tonë kosovare.

Gjatë studimit të temës, kemi vënë re se vendi ynë Kosova çdo ditë e më shumë po krijon mjedis të përshtatshëm për ngritjen dhe rritjen e madhësisë së fermave dhe po ashtu për mbajtjen e të rinjëve në tokat e tyre dhe kjo vjen si rezultat i trendeve pozitive të mbështetjes me anë të subvencioneve dhe granteve, pastaj duke përmirësuar sferën kredituese të bankava për bujqësi dhe po ashtu të sigurimit të dëmeve apo aktiviteteve bujqësore në përgjithësi. Mund të jetë modest trendi i rritjes, por megjithatë, ngelet pozitiv, i kënaqshëm dhe shpresëdhënës.

Në fund një arsye tjetër e zgjedhjes dhe elaborimit të kësaj teme është motivi im i cili më vije si rrjedhojë e studimeve të mia tre-vjeçare në këtë fushë dhe gjithashtu e praktikës sime profesionale në një nga agjencionet më me peshë në egzekutimin e këtyre masave bujqësore Agjencioni për Zhvillim Rural, pasi që jam njohur për nga afër se si implementohen këto politika agrare, duke mos harruar faktin që studimi i politikave bujqësore që nxisin zhvillim të zonave rurale, përbëjnë të preferuarën time. Bashkë me mentorin e temës, duam që në këtë hulumtim të vëm në diskutim idenë e matjes së ndikimit të granteve në bujqësi dhe po ashtu të shërbejë si material mbështetës për projekte të tjera të kësaj natyre.

1.3. Objektivat

Objektivi i këtij studimi është të përcaktoj ndikimin e granteve në zhvillimin e sektorit të bujqësisë, respektivisht në rritjen e punësueshmërisë dhe prodhimtarisë bujqësore në rajonin e Prizrenit, thënë ndryshe cili ka qenë roli i granteve si masë e zhvillimit rural, të Planit të Zhvillimit rural dhe Bujqësor të Kosovës (PZHRB) në avansimin e përgjithshëm bujqësor në Kosovë dhe posaqërisht në rajonin e Prizrenit.

Objektivi i parë i këtij studimi është të analizojë rolin dhe rëndësinë e granteve investuese në zhvillimin e sektorit bujqësorë në vendin tonë, Kosovë.

Objektivi i dytë është të tregojë se cila është përvoja e implementimit të kësaj mase të politikës bujqësore në Kosovë.

Objektivi i tretë i punës sonë studimore është të prezantojë gjendjen aktuale të sektorëve bujqësorë në Kosovë, barrierat mbështetëse financiare nëpër të cilat kalon dhe influenca pozitive që kanë pasur masat e politikës bujqësore si pagesat direkte dhe grantet investuese në zhvillimin e zonave rurale në përgjithësi.

Objektivi i katërt është të identifikojë çështjet e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së si dhe rrugën që duhet ndjekur Kosova për të dinamizuar zhvillimin e bujqësisë në vend.

Objektivi i pestë i studimit është formulimi i rekomandimeve. Hulumtimi përmbillet me të gjeturat dhe rekomandimet në çështjet e identifikuar.

1.4. Pytjet kërkimore/hipotezat

Masat e zhvillimit rural, të Planit të Zhvillimit rural dhe Bujqësor të Kosovës (PZHRB), mbështetëse të fermerëve (pagesat direkte dhe grantet investuese) kanë pasur efekte pozitive që nga aprovimi dhe implementimi i tyre, në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe të zhvillimit rural në aspekt të përgjithshëm.

Studimi ynë ka ngritur këto hipoteza, që janë të ndërlidhura me ndikimin e dhënë të granteve investuese në prodhimtari dhe punësueshmëri në sektorin e bujqësisë:

“grantet kanë influencuar në përmirësim të cilësisë së jetës së banorëve në zonat rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve në ferma dhe kjo krijon vende të reja të punës dhe rritje të të ardhurave”

“kanë mbështetur mbrojtjen e mjedisit dhe e resurseve natyrore, nëpërmjet investimeve në ujë, kullim, trajtim të mbetjeve, si dhe në energji të ripërtëritshme”

“kanë rritur aftësinë konkurruese të produkteve bujqësore që bazohet në përdorimin e teknologjisë moderne, pastaj kanë rritur prodhimin dhe produktivitetin, sigurinë e ushqimit dhe zvogëluar bilancin negativ tregtar”

Hulumtimin tonë, më tutje e kemi shtrirë mbështetur mbi këto pyetje hulumtuese:

Pyetja kryesore:

- Si dhe në çfarë mase **grantet investuese** si masa mbështetëse në kuadër të politikave agrare kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në përmirësimin e potencialeve prodhuese të sektorëve bujqësore dhe rrjedhimisht në ngritjen e standartit jetësorë të popullsisë rurale në Kosovë?

Pyetje të tjera:

- Cili është roli dhe rëndësia e bujqësisë në ekonominë tonë vendore dhe cila është pjesëmarrja e saj në Bruto Produktin Vendor?
- Cila është gjendja aktuale e bujqësisë në Kosovë duke përfshirë këtu edhe statistikat mbi kapacitetet e fermave?
- Kush ka qenë efekti i politikave agrare dhe të politikave të përbashkëta bujqësore mbi zhvillimet progresive të sektorëve bujqësorë?
- Cili është rezultati i granteve investuese në rritjen e sipërfaqeve kultivuese, diversifikim të aktiviteteve dhe kulturave bujqësore, në rritjen e prodhimtarisë, në rritjen e punësueshmërisë dhe të të ardhurave për fermerët?

1.5. Organizimi i punimit

Hulumtimi është organizuar në gjashtë kapituj! Në kapitullin e parë shtjellohet sfondi i problemit dhe objektivat e hulumtimit të temës. Kapitulli i dytë paraqet një rishikim të literaturës mbi konceptet e politikave agrare, Politikave të Përbashkëta Bujqësore dhe mbi masat mbështetëse politike të Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Kapitulli i tretë ofron të dhëna dhe informacione mbi bujqësinë në Kosovë, historikun dhe gjendjen aktuale të saj. Kapitulli i katërt trajton metodologjinë e hulumtimit dhe të dhënat e mbledhura për këtë punim diplome. Diskutimi i rezultateve mbi temën e studiuar, që respektivisht përmbushin objektivat dhe vërtetojnë hipotezat, janë elaboruar në kapitullin e pestë. Punimi përfundon me konkluzionet mbi temë nën diskutim si dhe rekomandimet për politikatat e mbështetjes së bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë.

2. RISHIKIMI I LITERATURWS

2.1 Politikat agrare dhe roli i politikave në zhvillimin e bujqësisë në Kosovë

Politika agrare paraqet një grup të vendimeve dhe veprimeve qeveritare lidhur me prodhimtarinë bujqësore vendore. Ajo është pjesë e politikës ekonomike. Sipas teoricientëve gjerman, politika agrare shqyrton dhe siguron bazën për bartësit e politikës në nxitjen e zhvillimit bujqësor. Ajo hulumton masat ligjore, teknikën e përparimit të bujqësisë, politikën arsimore, kreditore, të eksportit-importit, format e bashkimit etj. Politikat agrare përcaktojnë objektivat, masat dhe planin për zhvillim bujqësor dhe rural. Me fjalë tjera, ajo merret me mekanizmat makroekonomik bujqësor dhe me përcaktimin e rolit të bujqësisë në rrjedhat makroekonomike të vendit. Ndërsa organizimi i ndërmarrjeve bujqësore i shqyrton qëshjet mikroekonomike. Mes tyre nuk ka ndonjë ndarje rigoroze. Politikat agrare mund të jenë në nivel të shtetit por edhe në nivel lokal kur dëshirohet zhvillimi i një regjioni të vecantë(Gjergjizi).

Ato ndikohen nga shumë faktorë ekonomik dhe joekonomik, varësisht nga niveli i zhvillimit të vendit. Ato gjithashtu ndikohen edhe nga grupet e ndryshme të interesit sic janë fermerët, ndërmarrjet bujqësore, konsumatorët etj. Politikat agrare mund të jenë nxitëse ose kufizuese. Në rastet kur kërkohet rritja e prodhimtarisë, shteti aplikon masa lehtësuese për prodhim si psh. të zvoglojë tatimet, doganat për pleh, fara, pesticide, makineri bujqësore etj. Ndërsa në rastet kur shteti kërkon ta zvoglojë prodhimin, atëherë ai aplikon masa të cilat pengojnë rritjen e prodhimtarisë.

Politikat agrare kanë një fushë të gjërë të veprimit. Ato ndahen në:

- *Politika bujqësore* të cilat merren me administrimin e faktorëve të prodhimit siç është pronësia mbi tokë, eliminimin e faktorëve destabilizues të tregjeve bujqësore etj. Ato iu kushtohen prodhuesve bujqësor.
- *Politikat agro-industriale* merren me çështjet e furnizimit të bujqësisë me inpute dhe përpunimin e tyre.

- *Politikat ushqimore* merren me çështjet e çmimeve të ushqimit, me subvencione dhe ndihma të ndryshme, çështjet higjienike-sanitare të ushqimit etj. Këto politika i favorizojnë konsumatorët.
- *Politikat e zhvillimit rural* favorizojnë zhvillimin e zonave rurale në përgjithësi si psh. sistemin shkollor dhe shëndetësor në këto zona, infrastrukturën rurale, investimet direkte, kooperimin etj.(Gjergjizi).

Politikat agrare realizohen përmes mekanizmave të ndërlikuar ekonomik. Masat e politikës agrare janë:

- *Politika e çmimeve të prodhimeve bujqësore* janë masa ligjore të cilat ndërmiren për t'u mbrojtur nga çrregullimet e mundshmetë çmimeve të cilat ndodhin gjatë formimit të lirë të tyre në bazë të ofertës dhe kërkesës.
- *Tatimet* janë masë e vjetër ekonomike dhe masë e politikës agrare. Si bazë tatimore kanë shërbyer sipërfaqet, banorët, pasuria, të ardhurat për shtëpi, të dhënat kadastrale etj. Niveli i tatimit është përcaktuar varësisht nga nevojat e shtetit dhe nga mundësitë e prodhuesve bujqësor për të paguar.
- *Investimet* paraqesin një nga masat kryesore të zhvillimit bujqësor. Historikisht, bujqësia ka pasë nivel të ulët të investimeve nga mjetet vetanake.
- *Kreditimi* ka një rëndësi të lartë në politikën agrare. Përmes kreditimit, akumulimet shoqërore futen në përdorim me qëllim të realizimit të veprimtarive të ndryshme produktive. Në bujqësi, kreditë mund të përdoren për të investuar në mjete themelore dhe në mjete të xhiros apo të prodhimtarisë vijuese. Karakteristikat e prodhimtarisë bujqësore siç janë: aftësia e ulët akumuluese e profitit, karakteri biologjik, ndikimi ikushteve natyrore, efikasiteti i ulët i investimeve, numrit të madh të shfrytëzuesve ndikojnë në aftësitë e bujqëve për përfitim të kredive.
- *Subvencionet* aplikohen nga shteti me qëllim të ruajtjes së nivelit të të ardhurave të cilat mund të zvoglohen si rezultat i problemeve në tregun e brendshëm, vështirësive nërealizimin e eksportit, aplikimit të ndonjë teknologjie të avancuar të prodhimit apo masave agroteknike, nxitjen e prodhimit etj. Ato bëjnë pjesë në politikat zhvillimore.
- *Këmbimet tregtare* janë masat me anë të së cilave rregullohet eksporti dhe importi i produkteve bujqësore. Shteti siguron masa lehtësuese për eksportuesit e produkteve bujqësore me anë të doganave, premive eksportuese etj. Ndërsa për ti

mbrojtur produktet vendore nga konkurenca e jashtme aplikon mekanizma mbrojtjës përmes masave doganore (Skreli, 2006).

2.2 Plani për Zhvillim Rural dhe Bujqësorë 2014-2020

Departamenti i Zhvillimit Rural i MBPZHR-së, me mbështetjen e një projekti binjakëzimi, hartoi një Program shumëvjeçar për Zhvillimin Rural dhe Bujqësorë (PZHRB) për të mbuluar periudhën 2014-2020. Megjithëse është miratuar nga Qeveria, PZHRB 2014-2020 akoma nuk është miratuar zyrtarisht nga Parlamenti i Kosovës (siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar në rastin e strategjive shumëvjeçare). Zbatohen përmes programeve kombëtare vjetore (skema grantesh) të cilat miratohen me Udhëzime Administrative Ministrore dhe financohen nga buxheti kombëtar. Masat e konsideruara në këto programe vjetore mund të ndryshojnë nga viti në vit (sipas prioriteteve kombëtare), por duhet të mbeten të përafuara me PZHRB-në e përgjithshme (Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

PZHRB 2014-2020 është hartuar për të pasqyruar politikën kombëtare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe ka këto objektiva specifike:

- Rritja e konkurrencës dhe efikasitetit të prodhimit primar bujqësor, përpunimit dhe marketingut;
- Përmirësimi i higjienës në fermat dhe në vendet e përpunimit;
- Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm rural duke investuar në infrastrukturën rurale dhe duke promovuar zhvillimin ekonomik i cili merr parasysh standardet e mbrojtjes së mjedisit; dhe
- Krijimi i mundësive të reja të punës përmes diversifikimit rural (Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

PZHRB është strukturuar në mënyrë të ngjashme me një program të Instrumentit për Përkrahimin në Zhvillimin Rural (IPARD) dhe përfshin masat e mëposhtme që janë të ngjashme me ato të IPARD:

- Masa 101 - investimet në asetet fizike të fermave bujqësore;
- Masa 103 - investimet në asetet fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit;
- Masa 201 - masat agro-mjedisore dhe bujqësia organike;

- Masa 202 - krijimi dhe mbrojtja e pyjeve;
- Masa 302 - diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit; dhe
- Masa 303 - përgatitja dhe zbatimi i strategjive zhvillimore lokale përmes qasjes LEADER;
- Masa 401 - përmirësimi i trajnimit;
- Masa 402 - shërbimet këshillimore;
- Masa 501 - asistencë teknike dhe mbështetje për Rrjetin Rural(Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

Objektivat dhe prioritetet e Planit për Zhvillim Rural dhe Bujqësorë

Objektivat e përgjithshme të PZHRB 2014-2020 janë të njëjta me ato të identifikuar në Strategjinë Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për të njëjtën periudhë dhe janë plotësisht në përputhje me objektivat e IPARD. Ato gjithashtu korrespondojnë drejtpërdrejt me objektivat e përgjithshme të shtyllës së dytë të Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB), e cila synon të arrijë rritje të qëndrueshme, të zgjuar dhe gjithëpërfshirëse midis zonave rurale.

Tre objektivat e përgjithshme të PZHRB-së janë:

- Zhvillimi i një sektori agro-ushqimor konkurrues dhe inovativ i karakterizuar nga i) rritja e produktivitetit; dhe ii) prodhimin e produkteve me cilësi të lartë që plotësojnë kërkesat e tregut të BE-së. Sektori gjithashtu duhet të kontribuojë në sigurinë dhe sigurinë e furnizimit të ushqimit në vend, të nxisë punësimin dhe të zhvillojë kapitalin njerëzor dhe fizik;
- Të mbrojë burimet natyrore dhe mjedisin duke adresuar sfidat e ndryshimeve klimatike duke arritur përdorimin e qëndrueshëm dhe efikas të tokës dhe menaxhimin e pyjeve dhe duke futur metoda të prodhimit bujqësor që ruajnë mjedisin; dhe
- Për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të diversifikuar mundësitë për punë në zonat rurale duke nxitur punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e balancuar territorial(Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

Tabela 1. PZHRB 2014-2020 buxheti total indikativ për masë

PRIORITETET	2014-2020					
	Kontributi publik (EUR)	Intensiteti i ndihmës	Kontributi privat (EUR)		Investimi total (EUR)	Shpërndarja e buxhetit për masë
1	2	3	4	6	6=2+4	7=2 në %
Prioriteti 1: Rritja e qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së fermës	71,242,574		55,637,058		126,879,632	79%
101 Investime në asetet fizike të fermave bujqësore	46,816,549	60%	31,211,032	40%	78,027,581	66%
103 Investimet në asetet fizike në lidhje me përpunimin & marketingun	24,426,025	50%	24,426,025	50%	48,852,051	34%
Prioriteti 2: Rivendosja, ruajtja dhe rritja e ekosistemeve	1,245,664		-		1,245,664	1%
201 Masat mjedisore Agri dhe bujqësia organike	495,664	100%	-	0%	495,664	40%
202 Themelimi dhe mbrojtja e pyjeve	750,000	100%	-	0%	750,000	60%
Prioriteti 3: Promovimi i përfshirjes sociale dhe ekonomike	15,027,318		4,946,708		19,974,026	17%
302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit	9,186,744	65%	4,946,708	35%	14,133,452	61%
303 Përgatitja dhe zbatimi i Strategjive Lokale të Zhvillimit	5,840,574	100%	-	0%	5,840,574	39%
Prioriteti 4: Transferimi i njohurive dhe inovacionit	2,855,000		-		2,855,000	3%
401 Përmirësimi i trajnimit	1,200,000	100%	-	0%	1,200,000	42%
402 Shërbim këshillimor	875,000	100%	-	0%	875,000	31%
501 Asistencë teknike	780,000	100%	-	0%	780,000	27%
TOTALI	90,370,556		60,583,766		150,954,322	100%

Burimi: PZHRB 2014-2020

Mbështetja për krijimin e strukturave dhe kapaciteteve për menaxhimin e fondeve IPARD në bujqësi, në kuadër të përgatitjes për transferimin e menaxhimit të fondeve të BE, është një element i rëndësishëm i ndihmës IPA për periudhën 2014-2020. Forcimi institucional i MBPZHR-së për programin shumëvjeçarë të zhvillimit rural dhe krijimi i kornizave të duhura të zbatimit, tashmë ishte iniciuar nga IPA I.

Rezultatet e pritura të asistencës IPA në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural deri në vitin 2020 janë:

- Operatorët e biznesit të ushqimit dhe prodhuesit janë të përgatitur të jenë konkurrues në tregun rajonal dhe BE, pasi të plotësohen standardet e sigurisë ushqimore, me shërbime këshilluese gjerësisht të disponueshme;
- Fermerët janë trajnuar dhe janë të njohur me menaxhimin e fondeve për bujqësi dhe janë të gatshëm të kalojnë në përdorimin e fondeve të Politikës së Përbashkët Bujqësore
- Qasja në kredi rritet për fermerët dhe operatorët agro-ushqimor (në bashkëpunim me Institucionet Financiare);
- Trajnimi profesional, duke përfshirë menaxhimin e fermës dhe kontabilitetin, është futur për të rritur punësimin dhe të ardhurat;
- Përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të tokës dhe organizimit të tregut të tokës, duke përfshirë reduktimin e ndërtimeve ilegale në tokën bujqësore; dhe
- Përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të ujit dhe ujitjes, me lidhje të qarta me strategjinë kombëtare të ujit të hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)(Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

Objektivat specifike të PZHRB 2014-2020 janë:

- Rritja e konkurrencës së prodhuesve primar bujqësor;
- Përmirësimi i përpunimit dhe marketingut të produkteve primare bujqësore dhe pyjore përmes rritjes së efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së sektorit të përpunimit;
- Përmirësimi i standardeve dhe higjenës së cilësisë në fermat dhe objektet e përpunimit;
- Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm rural duke investuar në infrastrukturën rurale dhe duke promovuar zhvillimin ekonomik që respekton standardet e mbrojtjes së mjedisit;
- Krijimi i mundësive të reja të punës përmes diversifikimit rural.
- Rëndësia, efikasiteti, efektiviteti dhe kontributi ndaj ndikimit të programit kundrejt objektivave të përcaktuara u ndikuan fuqimisht nga mënyra se si është zbatuar programi deri më tani(Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

Analiza SWOT e PZHRB-së identifikoi një sërë pengesash për zhvillimin e zonave rurale dhe përmirësimin e fermave bujqësore dhe bizneseve të përpunimit të ushqimit, duke përfshirë:

- një përhapje të fermave dhe parcelave të vogla;

- përdorimi i sistemeve tradicionale "të hapura" të ujitjes, shumica e të cilave janë në gjendje të keqe;
- mungesa e shkathtësive dhe kompetencave në sistemet moderne të prodhimit bujqësor;
- mungesa e njohurive për praktikat efikase të prodhimit dhe mundësitë e tregut;
- mbështetje e dobët për të gjitha llojet e inovacionit;
- pozicionet e dobëta të tregut midis prodhuesve të vegjël;
- paqartësi mbi titujt e tokës;
- boshllëqe të rëndësishme në zinxhirët e vlerave të ndryshme; dhe
- pajisjet fizike të vjetruara dhe joefikase (Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

Ndikimi dhe studimi i thelluar i Programit të Granteve për Zhvillim Rural në Kosovë

Ndikimi dhe studimi i thellë i ***Programit të Granteve për Zhvillim Rural në Kosovë*** u zhvillua në vitin 2015 dhe përfundoi në shkurt 2016. Dy nën-sektorë (qumësht dhe fruta) u përzgjedhën për analiza të hollësishme. Studimi tregoi se sistemi i grantit ishte i paefektshëm në fillim, me propozim projektet e dorëzuara në zyrat përkatëse bujqësore komunale (stafi i të cilëve nuk ishte teknikisht i përgatitur për t'i vlerësuar ato). Situata u përmirësua me transferimin e aplikacioneve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), edhe pse studimi i thelluar përcaktoi se edhe AZHB i mungonte përvoja e nevojshme institucionale dhe kërkon forcim të mëtejshëm (Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

Investimet e mbështetura në PGZHR iu mundësuan prodhuesve bujqësorë të përmirësojnë operacionet e tyre bujqësore dhe si rezultat, për të rritur të ardhurat e tyre. Mbështetja e ofruar përmes PGZHR ka rezultuar në krijimin e punësimit shtesë në fermat përfituese. Produktiviteti është përmirësuar, megjithëse me rezultate të përziera në të gjithë përfituesit dhe nënsektorët, me efekte më të mira për shembull për prodhuesit e qumështit sesa prodhuesit e frutave (Masa 101). PGZHR gjithashtu përmirësoi konkurrueshmërinë e prodhuesve bujqësorë të mbështetur. Përzgjedhja e fermave dhe ndërmarrjeve më të forta ekonomike (Masa 101) si grupi i synuar për mbështetjen e PGZHR nuk ishte gjithnjë i justifikueshëm, me vlerësimin e disa propozimeve që favorizonin statusin ekonomik dhe socio-ekonomik mbi cilësinë e propozimit të paraqitur. Cilësia e planeve të biznesit të paraqitur nuk u shqyrtua aspak.

Pëpunuesit e ushqimit (Masa 103) të cilët kanë marrë mbështetje nga PGZHR ishin më të vogla, më të pajisura dhe të karakterizuara nga intensiteti më i lartë i punës dhe nga prodhimi më i ulët i punës dhe i kapitalit sesa mesatarja jo përfituese. Efekti i PGZHR (Masa 103) në fitimet bruto të ndërmarrjeve të përpunimit të ushqimit të mbështetura ishte pozitiv, por mjaft i ulët dhe efekti në punësim modest. Jo vetëm ishin efektet e humbjes vdekjeprurëse të programit në mesin e përfituesve të masës 103 të lartë, por Programi gjithashtu duket se ka më shumë zëvendësim (me mbështetjen e investimeve të DANIDA / Bankës Botërore në masë të madhe duke zëvendësuar ose duke zhvendosur kapitalin tjetër privat) sesa efekt plotësues mbi përfituesit e Masa 103.

Grantet, së bashku me ndihmën e konsiderueshme të marrë nga donatorë të tjerë, kontribuan në rritjen e numrit të përpunuesve aktivë në Kosovë, gjë që në anën tjetër nxiti konkurrencën. Pozicioni i fermerëve kundrejt degëve të tyre u përmirësua me përforsimin ekonomik të kompanive të përpunimit në drejtim të rrymës, me mbështetjen që rezultoi për shembull në lidhje më të forta midis prodhuesve të qumështit të papërpunuar dhe përpunuesve të qumështit përgjatë zinxhirit të vlerës. Megjithatë, sektorët e bujqësisë dhe të ushqimit në Kosovë u konsideruan joefikasë, veçanërisht për shkak të kufizimeve të lidhura me furnizimin e pamjaftueshëm të mallrave të rëndësishme publike (Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al), 2019).

2.3 Politikat e Përbashkëta Bujqësore të BE-së

Me nënshkrimin e Traktatit të Romës në vitin 1957 dhe me themelimin e Komunitetit Ekonomik Evropian nga gjashtë shtetet evropiane (Franca, Gjermania, Italia, Belgjika, Luksemburgu dhe Holanda) në Janar të vitit 1958, lindi ideja për themelimin e një Politike të Përbashkët Bujqësore për këto vende. Politika e përbashkët synonte:

- a) të rrisë produktivitetin bujqësor duke promovuar progresin teknik, duke siguruar zhvillimin e prodhimit bujqësor dhe shfrytëzimit optimal të faktorëve të prodhimit, në veçanti të fuqisë puntore;
- b) në këtë mënyrë të siguroj një standard të drejtë të jetesës për komunitetin bujqësor, duke rritur të ardhurat individuale të personave të angazhuar në bujqësi;
- c) të stabilizojë tregjet;
- d) të sigurojë qëndrueshmërinë e furnizimeve;

- e) të sigurojë çmime të arsyeshme të furnizimeve për konsumatorët (Costa, C. Osborne, M. Zhang, C. et, Al., 2009).

Në vitin 1960, Komisioni Evropian prezantoi propozimin për Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB). Propozimi përfshinte tri parime kryesorë për politikën e përbashkët:

1. *Zhvillimi i tregtisë së lirë brenda komunitetit*: pa pengesa për tregtinë e produkteve bujqësore mes shteteve anëtare;
2. *Preferencë për produktet e Komunitetit*: furnizuesve nga Komuniteti duhej t'u jepej përparësi në tregje në raport me ata nga jashtë Komunitetit;
3. *Financimi i përbashkët*: menaxhimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve të krijuara nga PPB-ja, do të bëhej përmes buxhetit evropian (Zobbe, 2001).

Pra, mund të thuhet se ishin dy çështje kryesore me të cilat duhej të merrej politika bujqësore: *E para ishte sigurimi i ushqimit për popullsinë evropiane dhe e dyta sigurimi i të ardhurave për fermerët*. Sa i përket çështjes së parë, produktiviteti në vendet evropiane ishte shumë i ulët si rezultat i shkatërrime të bëra gjat Luftës së Dytë Botërore. Prandaj ndihmat për rritje të produktivitetit ishin thelbësore për tri arsye: *e para nga që popullsia vuante nga mungesa e ushqimit; e dyta nga që niveli i varshmërisë nga importi i produkteve ushqimore ishte i lartë; dhe e tretavalutat e huaja e posaqërisht dollari ishte një e mirë e rrallë*.

Në Politikën e Përbashkët Bujqësore të Evropës përfshiheshin skema e pagesave direkte për sipërfaqe të tokës së punueshme, skema e pagesave për lopë qumështore, pagesat për kafshë për majmëri, pagesat për thertore, për dele e dhi etj (Zobbe, 2001).

PPB përbëhet nga dy shtylla kryesore:

1. *Shtylla e parë* - e përbërë nga programi për mbështetje të tregut dhe të pagesave direkte, të cilat financohen nga Fondi i Garantuar Bujqësor Evropian (FGBE),
2. *Shtylla e dytë* - e përbërë nga programi për zhvillim rural, i cili financohet nga Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (FBEZHR).

Shtylla e parë e PPB-së përbëhet nga *masat për mbështetje të tregjeve dhe masat e pagesave direkte*.

Masat për mbështetje të tregjeve paraqesin çmimet e garantuara të disa produkteve bujqësore. Kjo skemë funksionon në atë mënyrë që kur çmimet në tregje vendore bien nën nivelin e çmimeve të garantuara, qeveria intervenon duke u marrë me sasinë e tepërt të prodhimit derisa çmimet vendore të nivelizohen me çmimet e garantuara. Suficiti i prodhimit mund të ruhet, shkatërrohet apo të eksportohet. Rritja e çmimeve botërore të ushqimit viteve të fundit ka ndikuar në uljen e shpenzimeve për masën e çmimeve të garantuara, e gjithashtu edhe reformat e PPB-së gjatë të cilave shumë mallra janë larguar nga kjo skemë (Costa, C. Osborne, M. Zhang, C. et, Al., 2009).

Masat e pagesave direkte ishin dizajnuar me qëllim të kompenzimit të fermerëve për uljen e çmimeve të garantuara, process ky që filloi në vitin 1992. Tradicionalisht kjo formë e pagesës ishte e lidhur me prodhim, varësisht nga sipërfaqet e kultivuara me kultura të veçanta ose numrin e kafshëve blegtorale ose me përdorimin e inputeve të veçanta gjatë procesit të prodhimit (Costa, C. Osborne, M. Zhang, C. et, Al., 2009).

Shtylla e II-të e PPB-së

Një politikë gjithëpërfshirëse për zhvillim rural është futur në pakon e reformës Agjenda 2000. Në këtë shtyllë u bashkuan skemat lidhur me mjedisin bujqësor dhe territorial. Pjesa e buxhetit e ndarë për këtë shtyllë është më e vogël se sa buxheti i ndarë për shtyllën e parë. Programi për zhvillim rural është i bashkëfinancuar nga Unioni Evropian dhe nga shtetet anëtare. Niveli i bashkëfinancimit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme mes shteteve (Costa, C. Osborne, M. Zhang, C. et, Al., 2009).

Programi për zhvillim rural është i organizuar në tri akse kryesore të cilat iu korrespondojnë tri objektivave kryesore të zhvillimit rural:

- **Aksi 1: Përmirësimi i aftësisë konkurruese të sektorëve të bujqësisë dhe pylltarisë** - ofron një sërë masash për të orientuar kapitalin njerëzor dhe fizik drejt sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe prodhimit të produkteve bujqësore me cilësi të lartë. Kjo është planifikuar të arrihet me anë të modernizimit të fermave, përmirësimit të shërbimeve këshillimore, rritjes së vlerës së produkteve bujqësore dhe pyjore etj.
- **Aksi 2: Përmirësimi i mjedisit dhe mbështetja e menaxhimit të tokës** - parashikon masa për të mbrojtur dhe shtuar vlerën e burimeve natyrore, ruajtjen e sistemeve pyjore dhe peisazheve kulturore në zonat rurale.

- **Aksi 3: Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe diversifikimi i ekonomisë rurale** - zhvillon infrastrukturën dhe kapitalin njerëzor në zona rurale me qëllim të përmirësimit të kushteve për zhvillim dhe diversifikim ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Ky aks ka për qëllim rritjen e aktiviteteve jo bujqësore në viset rurale, zhvillimin e turizmit rural, ruajtjen trashëgëmisë kulturore etj.

Programi i zhvillimit rural ka edhe dy elemente shtesë:

- **Aksi LEADER: Zhvillimi i partneriteteve lokale për të mobilizuar dhe zhvilluar komunitetet rurale** – Ky aks plotëson tre akset e lartpërmendura, me futjen e qasjes nga poshtë-lartë, me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm rural dhe të krijimit të një rrjeti dhe partneriteti për shkëmbim të përvojave.
- **Asistenca teknike: Është një aks shtesë, ndihmës në implementimin e akteve të tjera.** Mbështet realizimin e akteve tjera dhe sigurohet që bashkëpunimi mes tyre të jetë maksimal, duke siguruar shmangien e kontraditave të mundshme.

Përzgjedhja dhe implementimi i masave të zhvillimit rural është i decentralizuar në nivel kombëtar me qëllim të vlerësimit më të mirë të nevojave të secilës zone rurale. Shtetet anëtare janë përgjegjëse për përpilimin e planit të tyre kombëtar, në nivel kombëtar apo regjional për njëperiudhë shtatë vjeqare. Megjithatë, KE përcakton pjesën minimale që duhet shpenzuar në secilin aks, 10% në aksin e parë, 25% në aksin e dytë, 10% në aksin e tretë dhe 5% në aksin Leader, dhe plani i secilit shtet anëtar duhet të aprovohet nga KE (Costa, C. Osborne, M. Zhang, C. et, Al., 2009).

2.4 Reformat e politikës së përbashkët bujqësore evropiane

PPB ka pësuar reforma të rëndësishme që nga fillimi i viteve 1990, me qëllim përmirësimin e orientimit të tregut dhe tëpërshtatjes sa më të mirë të politikave bujqësore me nevojat e kohës të popullsisë evropiane.

Disa nga reformat më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar PPB janë:

- **1992 - Reforma “MacSharry”** reduktoi garantimin e çmimeve të tregut dhe rriti mbështetjen e të ardhurave direkte të fermerëve, veprimtaria e të cilëve ishte e lidhur me prodhimin e të mirave të caktuara bujqësore. Në këtë reformë gjithashtu u përfshi edhe limitimi i prodhimit me qëllim të zvoglimit të tepërimit ushqimor. Përveç kësaj, u implementuan edhe masat për zhvillim rural, të cilat në fokus kishin mbrojtjen e ambientit.

Reforma synonte përmirësimin e aftësisë konkurruese të bujqësisë të BE-së, stabilizimin e tregjeve bujqësore, diversifikimin e prodhimit si dhe stabilizimin e shpenzimeve buxhetore në BE(Cantore, N. Kennan, J. Page, Sh., 2011).

- **2000 - Reforma “Agenda 2000”** zgjeroi më tej orientimin e prodhimit për treg dhe aspektin mjedisor të PPB-së. Ajo integroi politikën e zhvillimit rural nëkornizën institucionale të PPB-së dhe vazhdoi më tej me reduktimin e intervenimeve në çmime, duke e zëvendësuar atë me pagesa direkte.

Objektivat e Agjenda 2000 përfshinin:

- a) Rritjen e konkurrueshmërisë dhe orientimit në treg,
 - b) Arritjen e sigurinë dhe cilësinë ushqimore,
 - c) Stabilizimin e të ardhurave të fermerëve,
 - d) Integrimin e kujdesit mjedisor në politikat bujqësore,
 - e) Zhvillimin vitalitetit të zonave rurale,
 - f) Thjeshtim dhe Decentralizim.
- **2003-** Rezultati më i rëndësishëm i kësaj reforme ishte ndërpreja e lidhjes në mes të pagesave direkte dhe prodhimit. Kjo lidhje kishte dërguar në orientimin e fermerëve vetëm në prodhim, pa konsideruar nevojat dhe preferencat e konsumatorëve e gjithashtu edhe në mbishfrytëzimin e resurseve natyrore.

Qëllimi kryesor i reformës ishte t’i nxisë fermerët të zgjidhnin fushën e veprimtarisë së tyre në bazë të kërkesave mbizotëruese të tregut. Reforma e vitit 2003 forcoi pagesat e ndara nga prodhimi, përmes prezantimit të Skemës së Pagesave të Vetme.OBT e ka vlerësuar këtë formë të pagesës si një masë që në shtrembërimin e tregjeve ka efekt minimal apo nuk ka fare efekt(Cantore, N. Kennan, J. Page, Sh., 2011).

- **2008 — Reforma “Health Check”** është bërë me qëllim që të modernizojë, të lehtësojë PPB dhe të heqë kufizimet për fermerët, duke i ndihmuar ata t’i përgjigjen më mirë sinjaleve të tregut dhe të përballen më lehtë me sfida të reja. Në këtë reformë të PPB-së u parapranë 5% reduktime të pagesave për ata fermerë që kanë pranuar më shumë se 5000 euro në kuadër të kësaj skeme dhe 4% reduktim nga shuma vjetore e pagesave për vlerat më të larta se 300,000 euro. Këto mjete, është parapranë të transferohen në buxhetin e

programit për zhvillim rural. Ndryshe kjo masë njihet si Rregullim. Në këtë reformë gjithashtu është paraparë që të shfuqizohet vendimi i cili i kushtëzonte fermerët të linin një pjesë së tokës të papunuar. Kjo do t'iu mundësojë atyre maksimizimin e potencialit prodhues.

Reforma “Health Check” ka tri objektiva kryesore:

- a) Thjeshtësimi i skemës së pagesave të vetme,
 - b) Masat e tregut,
 - c) Sfidat e reja ambientale.
- **PPB 2014-2020-** Reformat e reja të PPB të vitit 2013 u arritën si rezultat i tri vjet diskutimeve dhe negociatave. Për herë të parë në historinë e reformave të PPB-së, Parlamenti Evropian morri pjesë si bashkligjvënës me Komisionin Evropian. PPB është e ndarë gjithashtu në dy shtylla kryesore, mirëpo janë rritur lidhjet mes tyre, duke ofruar kështu një qasje më gjithpërfshirëse dhe të integruar për mbështetje të politikave. Të gjitha këto janë bërë me qëllim të përbaljes së sfidave më të cilat është ballafaquar dhe do të vazhdojë të ballafaqohet tërë sektori i bujqësisë e që një pjesë e madhe e tyre janë faktorë të jashtëm.

Këto sfida janë identifikuar si:

- *Sfida ekonomike* – që përfshinë sigurinë ushqimore dhe globalizimin, rënien e produktivitetit, luhatshmërinë e çmimeve, presionet mbi kostot e prodhimit për shkak të çmimeve të larta të inputeve dhe pozitën e përkeqësuar të fermerëve në zinxhirin e furnizimit të ushqimit.
- *Sfida mjedisore* – që është e lidhur me efikasitetin e përdorimit të burimeve natyrore, cilësinë e tokës dhe të ujit, menaxhimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit.
- *Sfida territoriale* – që paraqet problemet e dopopullimit dhe zhvendosjen e bizneseve nga zonat rurale (Cantore, N. Kennan, J. Page, Sh., 2011).

Me fjalë të tjera, këto sfida mund të paraqiten si tri objektivat afatgjata të PPB-së 2014-2020:

1. Prodhim i qëndrueshëm i ushqimit të sigurt;
2. Menaxhim i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe ndryshimeve klimatike;
3. Zhvillim i balancuar territorial.

Buxheti i përcaktuar i PPB-së është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2. Buxheti i PPB-së 2014-2020 në miliardë euro.

<i>Shtylla</i>	<i>Buxheti i PPB-së 2014-2020</i>
<i>Shtylla I</i>	312,74
<i>Shtylla II</i>	95,58
Totali	408,31

Burimi: Directorate-General for Agriculture and Rural Development

Për t'i arritur objektivat afatgjata të PPB-së, reforma fokusohet në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të instrumenteve të saj përmes:

- ***Rritjes së konkurrueshmërisë së bujqësisë evropiane*** – kjo do të bëhet duke i inkurajuar fermerët që vendimet për prodhim t'i bazojnë në kërkesat e tregut. Një instrument tjetër i rëndësishëm është edhe ndihma që do t'iu ofrohet fermerëve për hapjen e bizneseve të reja bujqësore dhe lidhja më e madhe mes shkencës dhe praktikës e cila do të realizohet përmes përmirësimit të sistemit këshillimor.
- ***Rritjen e qëndrueshmërisë së bujqësisë evropiane*** – rritja e vëmendjes së popullsisë për ruajtje të burimeve natyrore, ka ndikuar që sektori i bujqësisë të zhvillojë metoda më të qëndrueshme të prodhimit. Qëndrueshmëria e prodhimit do të arrihet përmes instrumenteve plotësuese dhe kombinimit të tyre.
- ***Një PPB më efektive dhe efikase*** – kjo do të arrihet përmes shpërndarjes më efektive dhe të barabartë të ndihmave mes shteteve anëtare dhe brenda tyre pasi që secili shtet është i lirë të bëjë rialokimin e mjeteve në bazë të nevojave që ata i kanë. Gjithashtu përparësi do t'iu ipet shumë fermerëve të rinj (DG Agriculture and Rural Development, 2013).

2.4.1 Vlerësimi përgjithshëm dhe rëndësia e granteve në Kosovë

Në Kosovë prodhimtaria bujqësore në përgjithësi është e ulët. Parcelizimi i madh i tokave, teknologjia e vjetruar, dhe konkurrenca jo e drejtë ka bërë që Kosova të mos mund të konkurrojë në treg me prodhimet e veta bujqësore. Përveç kësaj sa i përket sektorit bujqësor dhe zhvillimi rural në Kosovë ka edhe vështirësi të tjera që vazhdojnë të ekzistojnë ende. Nivel i ulët i efikasitetit të fermave, sipërfaqe mesatare e vogël, dhe prodhim bujqësor i fragmentuar, cilësia

e ulët e prodhimeve bujqësore, përpunim minimal i prodhimeve bujqësore, të ardhura të ulëta në dispozicion të ekonomive shtëpiake etj.

Gjithashtu treguesit e bilancit tregtar flasin për dominim të madh të prodhimeve të importit në tregu bujqësor i Kosovës. Posaçërisht problematik për gjendjen e sektorit të bujqësisë përbën fakti i përballjes me një konkurrencë të ashpër nga importi, dhe pa ndihmën e duhur të shtetit dhe fondeve të BE-së, donatorëve të tjerë vështirë, se mund të ketë kushte të favorshme dhe konkurruese për fermerët në Kosovë(Gjokaj, E. Veliu, N. Gjonbalaj, M., 2012).

Grandi për zhvillim është ofrimi i përkrahjes financiare për projekte intensive me bashkëfinancim, ku pjesëmarrja në bashkëfinancim mund të jetë në përqindje të ndryshme varësisht nga qëllimi dhe sasia e mjeteve në dispozicion.


Subvencionet paraqesin të ardhurat e ndryshme, të cilat i jep vendi apo shteti, dhe donatorët tjerë për një produkt të caktuar me të cilën mundësojnë prodhimin dhe përpunimin më të mirë të produktit. Për dallim nga grandet, pagesat direkte u jepen fermerëve për njësi (copë, kokë, ha etj). Thënë ndryshe kjo formë e përkrahjes bëhet 100% të shumës së paraparë dhe përfituesit përveç kriterëve të parapare si p.sh numri i krerëve, sipërfaqja në ha etj, nuk janë të obliguar të participojnë me mjete të veta(Gjokaj, E. Veliu, N. Gjonbalaj, M., 2012).

Grandet dhe subvencionet në Kosovë kanë synim zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe vendbanimeve rurale të Kosovës. Për arritjen e këtij synimi është ngrit një infrastrukturë e qëndrueshme në të cilën janë bashkuar të gjithë njerëzit që duan të merren me bujqësi dhe zhvillim rural. Në kuadër të kësaj infrastrukture, një rendësi shumë e madhe luajnë grantet dhe subvencionet që operohen nga MBPZHR përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës por edhe përmes donatorëve të ndryshëm siq është BE, USAIDI dhe donatorë të tjerë.

Zonat rurale të Kosovës për një kohë të gjatë janë përplasur me sfida të mëdha të cilat kanë krijuar pasiguri për sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe krijimit të mirëqenies për banorët e tyre. Por për fat të mirë, këto zona kanë favore agro-mjedisore dhe resurse të rëndësishme të cilat janë kusht për zhvillimin rural dhe bujqësor. MBPZHR-ja gjatë këtyre viteve ka dhënë kontribut të rëndësishëm për zhvillimin rural dhe bujqësor(Gjokaj, E. Veliu, N. Gjonbalaj, M., 2012).

Qëllimi i Qeverisë është që përmes programeve bujqësore të krijoj të ardhura të favorshme për fermerët, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë, ruajtjen e resurseve natyrore, mbrojtjen e tokës bujqësore, shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe konsolidimin e tokës bujqësore. Ky financim ndihmon drejtpërdrejtë agrobizneset dhe fermerët në zhvillimin e tyre afatgjatë. Pra, ky synim sipas tyre do të krijoj një qëndrueshmëri në zhvillimin e bujqësisë duke ndikuar në uljen e kostos në prodhimtari, grumbullim apo shpërndarje të produkteve bujqësore. Për këtë mbështetje në tri vitet e fundit janë shpenzuar rreth 131 milion euro (Zymeri, S. Thaqi, F. Hoxha, A., 2019).

Figura 1. Plani i shpenzimeve të MBPZHR për grante dhe subvencione për vitet 2016, 2017, 2018.




Burimi: Programet vjetore të Granteve dhe Subvencioneve për vitet 2016, 2017 dhe 2018 – MBPZHR

Përveç nivelit qendror, grante dhe subvencione ofrohen edhe nga komunat. Secila komunë bënë planifikimin për financimin e fermerëve në kuadër të buxhetit vjetor nga të hyrat vetanake të komunës apo donacione.

Në tabelën e më poshtme janë prezantuar shpenzimet e bëra nga shtatë (7) komunat për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Figura 2. Shpenzimet e shtatë komunave për grante dhe subvencioneve për tri vite.



Burimi: Zyra Kombëtare e Auditimit (2019)

Përmes sektorit të bujqësisë, Qeveria synon të ndikoj në zhvillimin ekonomik të vendit. Qeveria ka hartuar strategji afatgjate me prioritetet e vendit duke përfshirë edhe këtë sektor për të cilin shpenzohen mesatarisht 48 milion euro çdo vit nga fondet publike. Prej tyre nga niveli lokal shpenzohen rreth 4.5 milion euro në vit (Zymberi, S. Thaqi, F. Hoxha, A., 2019).

Tabela 3. Shpenzimet për bujqësi nga MBPZHR dhe komunat.

Viti/përshkrimi	Shpenzimet në nivel qendror	Shpenzimet në nivel lokal	Total
2018	€43,667,000	€5,506,772	€49,173,772,
2017	€43,869,000	€4,667,370	€48,536,370
2016	€43,894,000	€3,230,658	€47,124,658

Burimi: të dhëna nga MBPZHR, AZHB dhe komunat


Në bazë të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 përgatiten programet vjetore për grante dhe subvencione të cilat i mundësojnë fermerëve dhe agrobizneseve pjesëmarrje të lehtë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Kjo bëhet duke i mbështetur me financim prej 50% deri në 80% të investimit për grante ndërsa për subvencione (pagesa direkte) përmes shumave të përcaktuara në varësi të kulturës.

Me qëllim të zbatimit të programeve, hartohen edhe udhëzimet administrative që aprovohen nga ministri. AZhB ka për obligim ekzekutimin e tyre përmes një procesi transparent. Grantet dhe subvencionet duhet të jepen në pajtim me kriteret e parapara në program dhe sipas

periudhës së parashikuar. Ndërsa, përmes kontrolleve agjencia përcjellë zbatimin e projekteve dhe përmes monitorimit Ministria sigurohet se është duke arritur synimin për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Ministria në baza vjetore ka ofruar/planifikuar mesatarisht 21.6 milion euro në vit për grante duke mbështetur agrobiznese dhe fermerë në kultura të ndryshme bujqësore dhe infrastrukturë ekzistuese apo në ndërtim të tërësishëm (Zymberi, S. Thaqi, F. Hoxha, A., 2019).

Figura 3. Plani, miratimi dhe aprovimi për grante për vitet 2016, 2017 dhe 2018.



Burimi: Zyra Kombëtare e Auditimit

Për vitin 2018, vlera e planifikuar për grante ishte 27 milion euro. Prej tyre, 19 milion euro janë për programin vjetor ndërsa, 8 milion janë për programet e veçanta për ‘Zona rurale më pak të zhvilluara’ dhe ‘Infrastruktura rurale’. Përderisa, buxheti i aprovuar për grante ishte 21.5 milion euro. Pjesën e tejkalar të miratimit, Ministria e bartë si obligim kontraktual për vitin vijues. Si ilustrim në pasqyrat financiare të vitit 2018, Ministria ka shpalosur obligime kontraktuese në vlerë prej 19.9 milion euro (Zymberi, S. Thaqi, F. Hoxha, A., 2019).

Figura 4. Përmbajtja e granteve duke përfshirë masat dhe nën-masat e tyre.

Grantet

Masa 101 Investimi në asete fizike të ekonomive bujqësore

- 101.1 Sektori i pemëve
- 101.2 Sektori i perimeve dhe serrave
- 101.3 Sektori i mishit
- 101.4 Sektori i rrushit
- 101.1 Sektori i vezëve

Masa 302 Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit

- 302.1 Prodhimi, përpunimi dhe promovimi i mjaltit
- 302.2 Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i prodhimeve jo drusore të malit
- 302.3 Përpunimi dhe promovimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara
- 302.4 Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve artizanale

Masa 103 Investimi në asete fizike që kanë të bëjnë me përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe peshkatarisë

- 103.1 Përpunimi i qumështit
- 103.2 Përpunimi i mishit
- 103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve (përfshirë verën)
- 103.3.1 Përpunimi i pemëve dhe perimeve
- 103.3.2 Prodhimi i verës

Masa - Skema e ujitjes së tokave bujqësore

Burimi: Zyra Kombëtare e Auditimit, 2019

Masa 303 Implementimi i strategjive të zhvillimit lokal-Qasja Leader

- 303.1 Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territoreve të GLV-vw për GLV të zgjedhura
- 303.2 Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale për GLV të zgjedhura
- 303.3 Projektet e bashkëpunimit

Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore

Grantet dhe subvencionet në nivel komunal - Ferizaji

Krahas nivelit qendror, edhe komunat ofrojnë grante dhe subvencione për sektorin e bujqësisë. Për synim kanë mbështetjen e fermerëve në zonat e tyre. Kryesisht fokusohen në fermerët e vegjël të cilët nuk i arrijnë kriteret e nivelit qendror. Si shembull, Ministria mbështet fermerët me të mbjella mbi 2 hektarë ndërsa komuna deri në 2 hektarë.

Ferizaji ka Programin komunal për zhvillim të bujqësisë dhe një rregullore të përgjithshme ku është përfshirë edhe bujqësia. Mirëpo, programi nuk është i miratuar në Kuvendin Komunal dhe nuk është i nënshkruar rrjedhimisht nuk është bërë dokument i obliguar për përdorim. Ndërsa, rregullorja nuk ka ndonjë specifikë/rregullim që do t'i ndihmonte departamentit të bujqësisë për procedurat në ndarjen e granteve dhe subvencioneve (Zymberi, S. Thaqi, F. Hoxha, A., 2019).

Komuna e Ferizajit në vitet 2016, 2017 dhe 2018 ka investuar mbi 3 milion euro në sektorin e bujqësisë. Në dy vitet e fundit ka mbështetur fermerët për: furnizim me farë gruri, furnizim me farë misri, ndërtimi i serrave me participim, ndërtimi i stallave për bagëti të imta dhe për lopë qumështore me participim, furnizim me multikultivator dhe mjete të imta bujqësore, furnizimi i blegtorëve me lopë qumështore, ngritja e 3 ha me pemë arnore me participim, ngritja e 4 ha me pemë të imta; mjedër dhe dredhëz.

Komuna ka një projekt tre vjeçar për analiza të tokave bujqësore. Në zonat ku kanë përfunduar analizat, komuna me ekspertet kanë njoftuar të gjithë fermerët për gjendjen e tokave të tyre dhe se çka duhet të mbillen apo si duhet të përmirësohet toka e tyre. Komuna ka nënshkruar kontrata

me fermerët përfitues, që pajisjet e përfituara duhet ti mbajë sipas kontratës dhe për këtë janë paraparë kontrole nga komuna. Mirëpo, nuk ka ndonjë dokument që dëshmon nëse këto kontrole janë kryer nga komuna (Zymberi, S. Thaqi, F. Hoxha, A., 2019).

2.5 Aspektet gjeografike, klimatike dhe demografike të Kosovës

Kosova shtrihet në Evropën jug-lindore, në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik. Në jug-perëndim kufizohet me Shqipërinë, në veri-perëndim me Malin e Zi, në veri me Serbinë dhe në lindje dhe jug-perëndim me Maqedoninë.

Kosova zë një sipërfaqe afërsisht 10,900 km² dhe është i karakterizuar nga një lartësi mesatare 800 m mbi nivelin e detit, po duke treguar ndryshime vertikale të relievit dhe morfologjisë. Këto ndryshime morfologjike janë si pasojë e ndërtimit gjeologjik. Pika më e ulët e Kosovës ndodhet në luginën e lumit Drini i Bardhë, në kufi me Shqipërinë dhe arrin lartësinë 297 m mbi nivelin e detit. Pika më e lartë ndodhet në jug të Kosovës – në Gjeravicë – 2 565 m e lartë. Nga pikëpamja gjeografike, Kosova është e ndarë në dy njësi të mëdha të sheshta rajonale: Pjesa veri – lindore është quajtur si “Rrafshi i Kosovës”, pjesa jug – perëndimore është quajtur “Rrafshi i Dukagjinit” (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, 2019).

Klima e Kosovës është në pjesën më të madhe kontinentale, duke rezultuar me verë të ngrohtë dhe dimra të ftohtë me ndikime Mesdhetare dhe Alpine. Lugina midis Mitrovicës dhe Kaçanikut i përket zonës më të thatë të vendit. Në kontrast me të, fusha e Dukagjinit midis Pejës dhe Prizrenit është përshkruar si një zone shumë pjellore me më shumë reshje midis Nëntorit dhe Marsit.

Bazuar nga kushtet klimatike, Kosova mund të ndahet në tre zona klimatike si me poshtë:

1. Zona klimatike e Kosovës (Rrafshi i Kosovës),
2. Zona klimatike e Dukagjinit (Rrafshi i Dukagjinit) dhe
3. Zona klimatike e maleve dhe e pjesëve të pyllëzuara (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, 2019).

Mund të thuhet se pjesa më e madhe e Kosovës është e mbuluar me tokë pjellore dhe ka klimë të përshtatshme që garanton prodhimtari ekonomike të drithërave, pemëve, perimeve dhe

blegëtorisë. Klima është kontinentale, në lindje, me mesatarisht 660 mm të rreshura shiu me 170-200 ditë pa ngrica, ndërsa në juglindje, është e ndikuar nga klima mesdhetare me 780 mm të rreshura shiu dhe me 196-225 ditë me të ngruhta pa ngrica. Kjo bazë e kushteve krijon ambient të përshtatshëm për sigurimin e ushqimit të mjaftueshëm vetanak, në njërën anë, dhe mundësinë për një eksport modest, nga ana tjetër (Andersson,R. Hedquist,L. Kvist,I., 2001).

Demografia - Gjatë vitit 2017 popullsia e Kosovës pati një rritje natyrore për 20,406, ose shprehur në përqindje, u rrit për 1.13%. Gjatë vitit 2017 është vlerësuar se 9,376 persona kanë ndërruarvendbanimin (komunën) e tyre. Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2017 ishte (-5 431 banorë)(ASK, 2011).

Popullsia në Kosovë për vitin 2017 vlerësohet të jetë 1,798,506 banorë rezidentë. Popullsia rezidente e Kosovës, për periudhën 01 janar–31 dhjetor 2017 u rrit për 14,975 banorë, ose 0.84%. Dendësia e popullsisë 164.66 banorë përkm², dhe 0.14 ha (14 ari) për kokë/banori. Përderisa popullsia e Evropës po shkon drejt plakjes, popullsia e Kosovës po bën përjashtim(ASK, 2011).

Tabela 4. Popullsia rezidente dhe ekonomitë familjare private.

Popullsia e përgjithshme	1,739,825
Meshkuj	875,900
Femra	863,925
Raporti gjinor	101.4
Popullsia urbane	661,586
Popullsia rurale	1,078,239

Popullsia nën moshën 6 vjeç	179,648
% e popullsisë nën moshën 6 vjeç në popullsinë e përgjithshme	10.3
Popullsia e moshës mbi 65 vjeç	116,785
% e popullsisë së moshës mbi 65 vjeç në popullsinë e përgjithshme	6.7
Popullsia e moshës mbi 75 vjeç	38,922
% e popullsisë së moshës mbi 75 vjeç në popullsinë e përgjithshme	2.2
Numri i ekonomive familjare private	297,090
Numri mesatar i personave për ekonomi familjare private	5.9

BURIMI: Agjencioni i Statistikave të Kosovës

Kur bëhet dallimi në mes të zonave urbane dhe rurale zakonisht mendohet në madhësinë e vendbanimeve, pastaj në dendësinë e popullsisë, në shfrytëzimin e tokës dhe aktivitetet ekonomike. Kosova është një vend i vogël edhe përka sipërfaqja, edhe përka numri i popullsisë. Thuhet se ka një ndarje në mes të popullsisë rurale dhe urbane në raport prej 60:40. Mirëpo, shumë zona rurale janë afër zonave urbane dhe ekonomitë e të dyjave shpesh janë të ndërlidhura me lidhje tregtare dhe të punësimit.

Si të gjitha vendet e botës edhe popullsia e Kosovës jeton në zonat urbane dhe ato rurale, por është më e koncentruar në zonat rurale dhe sipas të dhënave më të reja mbi 60% e popullatës së Kosovës jetojnë në zonat rurale dhe veprimtari primare kanë aktivitetet bujqësore. Andaj niveli i rritjes dhe zhvillimit ekonomik të zonave rurale është i një rëndësie të posaqme për vendin (Zhvillimi Rural në Kosovë, 2004). Një prej prioriteteve të qeverisë është që të përkrahët zhvillimi rural dhe, përmes modernizimit dhe zgjerimit të bujqësisë dhe ekonomisë rurale, të ofrohen punësim dhe mjete të qëndrueshme jetese për popullsinë rurale (MASHT, MBPZHR, 2004).

Republika e Kosovës është ndarë në nivelin e parë të pushtetit vendor në shtatë rajone administrative, e të cilat janë:

- Rajoni i Mitrovicës
- Rajoni i Prishtinës
- Rajoni i Gjilanit
- Rajoni i Ferizajit
- Rajoni i Prizrenit
- Rajoni i Gjakovës


- Rajoni i Pejës

Tabela 5. Shtatë rajonet administrative të Kosovës.

Rajoni administrativ	Sipërfaqja (km ²)	Popullsia (regjistrimi 2011)	Dendësia (për km ²)	Kryeqyteti	Vendbanime
Ferizaj	1,030	185,806	180	Ferizaji	126
Gjakovë	1,129	194,672	170	Gjakova	170
Mitrovicë	2,077	272,247	110	Mitrovica	267
Gjilan	1,206	180,783	150	Gjilani	287
Pejë	1,365	174,235	130	Peja	118
Prishtinë	2,470	477,312	223	Prishtina	298
Prizren	1,397	331,670	240	Prizreni	195

Burimi: të përpunuara nga autori, të dhëna të bazuara në ASK dhe Wikipedia

2.5.1 Rajoni i Ferizajt



Rajoni i Ferizajt është njësi nga shtatë rajonet e Kosovës.

Rajoni i Ferizajt përfshin 5 komuna, të cilat janë:

- Komuna e Ferizajt
- Komuna e Shtimes
- Komuna e Kaçanikut

- Komuna e Hanit te Elezit
- Komuna e Shterpces

Qyteti i Ferizajt, është i vendosur në jug të Kosovës, më saktësisht në anën e djathtë të autostradës Prishtinë - Shkup, 37 kilometra larg nga kryeqyteti Prishtina. Komuna e Ferizajt ka 345 km², do të thotë vetë qytetit duke përfshirë edhe të tjera të 45 fshatrat rreth tij. Kjo zonë ka një popullsi prej 108,690 banorë. Ferizaj është relativisht një qytet i ri. Kjo komunë ka filluar të zhvillohet që nga viti 1873, kur hekurudha dhe stacioni hekurudhor janë ndërtuar. Në kohën e të folurit ka qenë një hotel, që ka ekzistuar dhe pronari i tij ishte Feriz Shashivari.

Bazuar në emër të pronarëve Feriz Shashivari këtë qytet Ferizaj emrin e poseduar. Pas luftës ky qytet u shkatërrua relativisht. Sot krahasuar me qytetet e tjera ai është konsideruar si qyteti i dytë më i zhvilluar pas Prishtinës në Kosovë dhe është qyteti i tregut në Kosovë. Disa nga fabrikat dhe ndërmarrjet që para shumë vitesh kanë qenë bazë për zgjerimin e ekonomisë në këtë komunë dhe janë ende funksionale. Disa nga këto fabrika dhe ndërmarrje janë: Fabrika e tubave të çelikut, fabrika e vajit, kombinati i drurit, fabrika për përpunimin e frutave ekzotike, fabrika e tullave etj. Siç u përmend më lart këto fabrika dhe ndërmarrje, në dritën e çdo gjë do funksionit por me shumë vështirësi si rezultat i periudhës së Privatizimit. Ferizaj është një qytet i rëndësishëm në Kosovë në shumë aspekte si p.sh: Kulturor, sportiv apo ekonomik, megjithatë organizimi i tij dhe arkitektura e bën atë një qytet shumë interesantë për t'u vizituar.

2.5.2 Përdorimi i tokës bujqësore

Kosova ka një sipërfaqe të përgjithshme prej afro 1.1 milion ha dhe llogaritet se 53% e tokës në Kosovë është bujqësore dhe 41% është tokë pyjore. Të dhënat e regjistrimit të bujqësisë tregojnë se në vitin 2014, gjithsej sipërfaqja e tokës së shfrytëzuar bujqësore ishte 413,635 ha (me 129,884 ekonomi bujqësore)(ASK, 2018). Nga sipërfaqja e tokës së shfrytëzuar bujqësore është vlerësuar se 88% ishte tokë e privatizuar, ndërsa 12% tokë shoqërore, që ishte në kuadër të ndërmarrjeve dhe kooperativave bujqësore(ASK, 2018).

Përdorimi i tokës dhe ndryshimet që ndodhin gjatë veprimeve tona, kanë implikime të rëndësishme ekonomike dhe mjedisore për prodhimin dhe tregtinë e produkteve bujqësore, ruajtjen e tokës dhe ujit, cilësinë e ajrit dhe përqendrimit e gazrave serrë. Shfrytëzimi i tokës bujqësore karakterizohet për nga format e përdorimit, aktivitetet dhe inputet që njerëzit i ndërmarrin në përdorimin e tokës për të prodhuar, ndryshuar, për të ruajtur ose konservuar atë.

Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore i referohet sipërfaqes së përgjithshme të tokës së punueshme-arat, livadhet dhe kullosat, kulturat shumëvjeçare dhe kopshtet e përdorura nga ekonomia bujqësore, pavarësisht nga lloji i zotërimit(MBPZHR , 2018).

Tabela 6. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2015-2017, (ha).

<i>Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore</i>	2015	2016	2017	<i>Ndyshimi 2017-2016</i>	<i>Ndyshimi% 2017/2016</i>	<i>Pjesëmarrja</i>
<i>Tokë e punueshme-ara</i>	185,36	187,223	186,954	-269	-0.14	44.9
<i>-nga e cila me perime në fushë të hapur</i>	6,859	7,864	8,033	169	2.15	-
<i>-nga e cila me perime në serra</i>	398	457	467	10	2.19	-
<i>Kopsht</i>	587	994	1,199	205	20.62	0.3
<i>Plantacione të pemëve</i>	4,727	5,493	6,247	754	13.73	1.5
<i>Plantacione të vreshtave</i>	3,068	3,112	3,199	87	2.80	0.8
<i>Fidanishte</i>	178	196	159	-37	-18.88	0.0
<i>Livadhe dhe kullosa</i>	216,41	218,808	218,314	-494	-0.32	52.5
<i>Gjithsej sipërfaqe shfrytëzuar e tokës bujqësore</i>	410,49	415,826	416,072	246	0.06	100

Burimi: Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore, 2017

Sipas të dhënave të Anketës së Ekonomive Bujqësore të vitit 2017, gjithsej sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore janë 416 mijë ha, prej të cilës pjesa më e madhe i përket livadheve

dhe kullsave (përfshirë tokën e përbashkët) 218.3 mijë ha ose 52.5%, ndërsa tokë e punueshme-ara (duke përjashtuar perimet) janë 186.9 mijë ha ose 44.9% (MBPZHR , 2018).

Bazuar në madhësinë e sipërfaqes së tokës së punueshme struktura e fermave klasifikohet në katër kategori kryesore:

- a) Fermat që kishin madhësi shumë të vogël, deri më pak se 1 ha përbëjnë 10% të fermave dhe kishin sipërfaqe prej 18,560 ha.
- b) Fermat me madhësi nga 1 deri më pak se 5 ha kishin pjesëmarrjen prej 48.4%, dhe përfaqësojnë rreth 89,594 ha.
- c) Fermat me madhësi prej 5 deri në më pak se 20 ha, kishin një përfaqësim prej 29.5% që përfshijnë sipërfaqe prej 54,677 ha, dhe
- d) Fermat me madhësi prej 20 e më shumë hektarë merrnin pjesë me 12.1% që përfshinë sipërfaqen prej 22,299 ha(MBPZHR , 2018).

Tabela 7. Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2017

Madhësia e fermës	Sipërfaqja (ha)	Pjesëmarrja (%)	Nr. Ekonomive Bujqësore	Pjesëmarrja (%)
0 dhe më pak se 0.5	5,976	3.23%	39,251	36.31%
0.5 deri më pak se 1	12,584	6.80%	18,543	17.15%
1 deri më pak se 2	29,898	16.15%	22,323	20.65%
2 deri më pak se 5	59,696	32.25%	20,460	18.93%
5 deri më pak se 10	37,458	20.23%	5,712	5.28%
10 deri më pak se 20	17,219	9.30%	1,331	1.23%
20 deri më pak se 30	5,332	2.88%	226	0.21%
30 e më shumë	16,967	9.16%	263	0.24%
Gjithsej	185,130	100%	108,108	100%

Burimi: Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2017

Sipas radhitjes që është prezantuar në tabelën më lartë, rrjedh se rreth 58.4% e të gjitha fermave në Kosovë kishin më pak se 5 ha sipërfaqe të shfrytëzuar bujqësore dhe së bashku këto fermame madhësi të vogël përbënin rreth 108,154 ha të tokës bujqësore të shfrytëzuar. Në anën tjetër, vetëm 20.23% e fermave me madhësi 5 deri më pak se 10 ha zotëronin sipërfaqe të tokës së shfrytëzuar prej 37,458 ha. Kur flasim për fermat më të mëdha duke u nisur prej 10 e më shumë

ha, posedonin vetëm 39,518 ha tokë bujqësore me pjesëmarrje prej 21.3%. Madhësia mesatare e fermës për familje rurale është **2.35 ha**(MBPZHR , 2018).

2.6 Historiku i bujqësisë

Para konfliktit të vitit 1998-99, Kosova ishte e organizuar në 29 komuna dhe e bazuar në ekonomi të komanduar. Brenda çdo komune funksiononin Asambletë dhe Drejtoritë Komunale të cilat e kontrollonin çdo aspekt të shërbimeve publike, edukimit, financave, taksave, sektorin e bujqësisë dhe ushqimit.

Spektori privat në Kosovë, në atë periudhë ishte një sektor shumë i rëndësishëm, dhe kontributi i tij në BPV u rrit nga 47% sa ishte më 1996, në 80% në vitin 1998. Mirëpo, situata e paqëndrueshme politike e bëri të vështirë tërheqjen e investitorëve të huaj dhe nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të mëdha industriale, ku prej 156 sa ishin gjithsej, vetëm 58 prej tyre ishin aktive. Në vitin 1999, sektori privat gjeneroi rreth 750 milion \$ të ardhura, ku 75 % e tyre vitin nga NVM(The World Bank, 2016).

Gjatë viteve 70-ta dhe 80-ta janë bërë investime të rëndësishme në sektorin privat dhe publik të bujqësisë. Sistemi i ujitjes u ndërtua për të rritur nivelin e prodhimit të kulturave pranverore, u bë gati mekanizimi total i punës dhe u shtua niveli i përdorimit të inuteve bujqësore. Gjatë kësaj periudhe, 75% e punimeve bujqësore në Kosovë ishin të mekanizuara. Mesatarisht, ishte një traktor për çdo 14 ha tokë të punuar. Shumica e fermerëve bënë pjesë në kooperativat bujqësore, të cilat ishin themeluar për të përkrahur shitjen e produkteve bujqësore, për t'iu dhënë fermerëve fuqi më të mëdha blerëse të inuteve dhe për të siguruar më lehtë kredi bujqësore(The World Bank, 2016).

Në Kosovën e paraluftës egzistonte një sistem i distribuimit të inuteve bujqësore i përbërë nga korporatat shtetërore (Agro-Kombinatet), kooperativat dhe ndërmarrjeve private. Sistemi përbëhej nga 17 Agro-Kombinate, 65 kooperativa shoqërore, 70 kooperativa të prodhuesve dhe rreth 200 tregtarëve privat(International Center for Soil Fertility , 2006).

Industria e përpunimit të ushqimit ishte pjesërisht në pronësi të shtetit dhe pjesërisht në atë privat. Pothuajse të gjithë mullitë, fabrikat e bukës, distileritë, prodhuesit e farave bashkëpunonin me fermat shtetërore dhe me kooperativat. Ndërsa sektori privat përbëhej nga disa mulli të grurit, përpunues të pemëve dhe perimeve dhe bodrumeve të verës. Sipas një

vlerësimi të 50 mullive privat në vitin 1999, ata kishin kapacitet të prodhonin 500,000 ton miell në vit, sa ishte e nevojshme për të përmbushur nevojat për Kosovë, mirëpo ishin të kufizuar nga furnizimi i dobët me energji elektrike, furnizimi me miell dhe nga hapësirat e pamjaftueshme për deponim(International Center for Soil Fertili , 2006).

Numri i përgjithshëm i bagëtisë në vitin 1997 ishte 421.000 gjedhë, 365.000 dele, 69.000 derra, 27.000 dhi dhe 4.5 milion koka shpezë. Gjatë luftës, kjo shifër gadi u përgjysmua. Prodhimtaria blegtorale do të mund të nxitet në mënyrë përmbajtësore falë posedimit të sipërfaqeve të konsiderueshme të kullosave dhe falë kostos së ulët të ushqimit të kafshëve që mundëson prodhimtarinë blegtorale(R. Andersson, L. Hedquist, I. Kvist,, 2001).

Spektori i bujqësisë ishte shumë i rëndësishëm për popullsinë në atë kohë. Këtë më së miri e dëshmon fakti që më shumë se 35% e BPV dhe 60% e të punësuarve ishte e bazuar në sektorin e bujqësisë. Këtu përfshiheshin farmerët dhe ndërmarrjet agrobiznesore të cilat mirreshin me prokurim, përpunim dhe distribuim të inputeve bujqësore dhe marketing dhe përpunim të produkteve finale bujqësore.Me perfundimin e luftës, sektori bujqësor i Kosovës ishte në një rrëmujë totale. Popullsia rurale ishte zhvendosur dhe të lashtat, bagëtitë dhe makineria ishte e dëmtuar ose e shkatërruar tërësisht. Mbijetesa dhe rimëkëmbja ishte totalisht e varur në sektorin e bujqësisë, në një kohë kur ekonomia rurale ishte në një nivel shumë të ulët të zhvillimit. Sipërfaqe të mëdha të tokës bujqësore kishin mbetur të pashfrytëzuara(Zhvillimi Rural në Kosovë, 2004).

Për këtë arsye, pas luftës, donatorë të ndryshëm kanë ndihmuar në rimëkëmbjen e bujqësisë në Kosovë. Në fazën e parë ndihmat kanë qenë kryesisht emergjente dhe janë bazuar në grante (lopë qumështore, mekanizim, serra etj.) Bujqësia kosovare shënoi një përmirësim të dukshëm dhe brenda një viti, prioritetet e donatorëve kaluan nga faza emergjente në fazën e zhvillimit të cilat ishin të nevojshme për të bërë sektorin e bujqësisë të qëndrueshëm dhe profitabil. Kjo fazë e dytë - faza zhvillimore përfshinte krijimin e politikave më të favorshme në bujqësi, transferimin e njohurive për teknologjitë e reja të kultivimit dhe në orientimin e prodhuesve bujqësorë drejt prodhimit komercial(Zhvillimi Rural në Kosovë, 2004).

Një nga programet më të rëndësishme i cili filloi në Tetor të vitit 1999 ishte Programi Emergjent për Agroinpute në Kosovë. Ky ishte program i financuar nga USAID, misioni i të cilit ishte ofrimi i asistencës për rritjen e kapacitetit prodhues të farmerëve, ndërmarrësve dhe

popullsisë në përgjithësi përmes lehtësimit të furnizimit efikas dhe me kohë me inpute bujqësore esenciale për zhvillim të sektorit bujqësor. Të arriturat e projektit ishin shumë të larta duke u bazuar në faktin se 40 million \$ u shpërndanë për fara, plehra dhe pesticide për mbjelljet pranverore të vitit 2000. Me fjalë të tjera, fermerëve iu ofrua mundësia për të rifilluar aktivitetet bujqësore, të sigurojnë ushqim për familje, e madje edhe të shesin një pjesë të prodhimit. Vende të reja të punës u hapën nëpër kompanitë e distribuimit, në insitucione kreditore dhe në kompanitë e tjera shërbyese. Kështu u bënë edhe hapat e parëtë zhvillimit ekonomik(International Center for Soil Fertili , 2006).

Me krijimin e institucioneve të para shtetërore, filluan edhe përpjekjet e tyre për përkrahje të bujqësisë. Hartimi i Programit për Zhvillim Rural dhe Bujqësor 2007-2013 është një nga të arriturat më të rëndësishme të MBPZHR-së, në të cilin ishte paraparë ndarja e granteve dhe subvencioneve, si instrument për zgjidhjen e disa problemeve me të cilat ballafaqohej bujqësia kosovare. Fillimisht buxheti i tij ishte i vogël krahasuar me nevojat, mirëpo vit pas viti, ai shkoi duke u rritur.

2.7 Gjendja aktuale në Bujqësi

Përkundër bazës burimore të favorshme, bujqësia në Kosovë ndeshet me katër kërcënime kryesore për ambientin, të cilat nëse mbesin pa kontroll, në të ardhmen gradualisht do ta rrënojnë reputacionin e sektorit. Këtu fjala është për konverzionin, fragmentimin dhe kontaminimin e tokës përmes instalimeve industriale dhe deponive të plehut. Problemi më i ngutshëm ambiental, tani, është konverzioni i tokës bujqësore në ate ndërtimore(Raport, 2010).

Si rezultat i mungesës së mbrojtjes institucionale të tokës bujqësore, ajo i është nënshtruar një shfrytëzimi shumë të madh për nevoja të tjera që nga periudha e pasluftës e mëtej. Kjo ka bërë që sipërfaqet me tokë bujqësore të zvogëlohen në vazhdimësi.Gjithashtu edhe sipërfaqet pyjore i janë nënshtruar dëmtimit të vazhdueshëm(AKMM, 2008). Në Kosovë cdo vit humbet mbi 2000 ha tokë bujqësore.

Këto humbje të vazhdueshme të tokës bujqësore dhe pyjorë në Kosovë mund të klasifikohen në dy grupe:

1. Humbjet e përhershme:

- Vendbanimet,

- Veprimtaritë komerciale,
- Industria,
- Komunikacioni,
- Akumulimet e ujit,
- Aeroportet

2. Humbjet e përkohshme:

- Mijet sipërfaqësore
- Eksploatimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës
- Hedhurinat e automjeteve (deponitë)
- Mbeturinat industriale
- Mbeturinat komunale
- Procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve etj(AKMM, 2008).

Problemi i dytë ambiental për të cilin ka nevojë të ndërmerret një aksion politik është fragmentimi i tokës që është duke u bërë. Aktualisht, sipërfaqja e tokës për një amvisëri është 0.5-2 ha. Këto sipërfaqe po fragmentohen për shkak të hyrjes të numrit të madhë të njerëzve të rinjë që duan të merren me bujqësi. Nëse lejohet të vazhdojë kështu, sipërfaqet e tokës do të bëhen shumë të vogëla, nën minimumin e arsyeshmërisë ekonomike. Përpjekja primare do të jetë minimizimi i fragmentimit të mëtejme të tokës me planet për konsolidimin gradual.

Problemet tjera te ambientit janë ndotjet industriale që ndodhin me dekada në rrethinën e shkrites së Mitrovicës (TREPÇA) dhe termocentraleve të Obliqit(R. Andersson, L. Hedquist, I. Kvist,, 2001).

Spektori i bujqësisë në Kosovë, ka nivel të ulët të efikasitetit dhe teknologji të vjetruar bujqësore, ferma të vogla gjysëmkomerciale, prodhim bujqësor të fragmentuar dhe cilësi të ulët të prodhimeve bujqësore. Si rezultat i sipërfaqeve të vogla të kultivuara, parcelizimit të madh të tokës dhe fondit të vogël blegtoral, shumë pak ferma, prodhimin e tyre e destinojnë për treg. Shumica e tyre nuk mund ti plotësojnë as nevojat e tyre familjare.

Gjithashtu treguesit e bilancit tregtar flasin për dominim të madh të prodhimeve të importit në tregun e Kosovës. Tregu Kosovar është i vërshuar nga prodhimet e importuara të cilat mjaft po i dëmtojnë prodhuesit vendor dhe ekonominë e Kosovës në përgjithësi, pasi që prodhimtaria vendore nuk po i plotëson nevojat e konsumit, një pjesë e madhe e prodhimeve importohet prej shteteve tjera për të përmbushur nevojat vendore. Edhe pse eksporti ka shënuar rritje, sasia e lartë e importit po ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në vitet e fundit vlera e importit të produkteve bujqësore (1-24) është rritur në vazhdimësi, por paralelisht edhe eksporti ka pasur rritje nga viti në vit. Meqenëse në vitin 2017, eksporti ka shënuar rritje, kjo ka rezultuar me një mbulueshmëri më të lartë të importit nga ana e eksportit përkatësisht përqindje të mbulimit prej 8.8% (tabela 8) (MBPZHR , 2018).

Tabela 8. Eksport-Import i produkteve bujqësore, në 1000 euro.

Viti	Eksporti	Importi	Bilanci tregtar	Eksporti/Importi (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2008	20,763	473,666	-452,903	4.4
2009	19,993	434,810	-414,817	4.6
2010	24,749	482,649	-457,900	5.1
2011	26,185	561,428	-535,243	4.7
2012	30,807	574,974	-544,167	5.4
2013	34,947	583,704	-548,757	6.0
2014	39,372	616,051	-576,679	6.4
2015	41,683	628,808	-587,125	6.6
2016	45,256	658,767	-613,511	6.8
2017	61,336	694,517	-633,181	8.8

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sektori i bujqësisë si aktivitet ekonomik shumë i rëndësishëm dhe strategjik për vendin tonë merr pjesë me **9%** të Bruto Produktit Vendor. Edhe pse ka një pjesëmarrje mjaft të lartë në BPV, bujqësia Kosovare karakterizohet me probleme strukturore si fragmentimi i tokës, ku si pasojë kemi edhe efikasitetin e ulët të punës gjë që shkakton koston e lartë të prodhimit. Si rezultat, i ndryshimeve strukturore në bujqësi është duke ndodhur një ritëm më i ngadaltë i zhvillimit (kalimi nga fermat tradicionale familjare në ato komerciale)(MBPZHR , 2018).

Sipas të dhënave të Regjistrimit të Bujqësisë në Kosovë në sektorin e bujqësisë punojnë 362,700 persona që llogaritur në njësi vjetore të punës janë 86,620 NjVP (1 NjVP=1800 orë pune në vit). Në raport me gjithsej numrin e të punësuarve bujqësia merr pjesë me rreth 25%(MBPZHR , 2018).

Një gjë që e kushtëzon zhvillimin e bujqësisë në Kosovë është mungesa e reshjeve të shiut gjatë muajve të verës dhe si rezultat suksesi i prodhimit varet nga ujitja, e kjo sidomos në Rrafshin e Kosovës ku niveli i të reshurave është më i ulët.

Pothuajse çdo herë gjatë stinës së verës të reshurat atmosferike mungojnë, ndërsa në stinët e tjera të reshurat janë të mjaftueshme, imponohet nevoja e akumulimit, grumbullimit dhe strukturimit të ujërave me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjatë verës për nevojat të ujitjes së kulturave bimore. Pa shfrytëzimin racional të pasurive ujore si dhe pa vendosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes nuk mund të arrihet zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme.

Si objektiva të përgjithshme për masën ujitja e tokave bujqësore janë:

- Rritja e produktivitetit të prodhimeve bujqësore;
- Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore;
- Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore;

Objektivat të veçanta për realizimin e kësaj mase janë:

- Modernizimi i sistemit për ujitje dhe kullim, duke zvogëluar humbjet në sasinë e ujit të përdorur, dhe
- Përmirësimi i lidhjeve të brendshme në rrjetet ekzistuese të ujitjes(MBPZHR, 2017).

2.7.1 Fuqitë dhe dobësitë e sektorit bujqësor dhe të zonave rurale

FUQITË

-Kushtet e mira klimatike dhe toka pjellore, sidomos për perime dhe fruta në rritje
-Shtimi i prodhimit bujqësor për shkak të rritjes së interes në prodhimin bujqësor dhe

mbështetjen e dhënë për sektorin në aspektin e pagesave direkte dhe granteve
- Zonat rurale kanë potencial të madh për krah pune dhe prodhimin e intensiv bujqësor të perimeve në veçanti

- Mbështetje për bujqësinë nga MBPZHR-ja dhe donatorët e tjerë kanë kontribuar dukshëm në futjen e teknologjive të reja të prodhimit
 - Përmirësimi i cilësisë dhe produktivitetit në prodhimet bujqësore, drithëra dhe perime
 - Rritja e ndërgjegjësimit të konsumit dhe kërkesës për produktet bujqësore vendase
 - Rritja e njohjes së qeverisë për rëndësinë e sektorit të bujqësisë dhe performancën e saj
 - Burimet e pasura natyrore, kushtet e mira natyrore dhe peisazhe të ndryshme
 - Mjedis më pak stresues dhe jetese më shpenzimet më të ulëta në zonën rurale
 - Gatishmëri e lartë e popullsisë për të përmirësuar gjendjen rurale;
- (Gjokaj, E. et,Al., 2016)

DOBËSITË

- GDP më të ulët për banor
- Varfëria e vazhdueshme, veçanërisht në zonat rurale
- Shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht në zonat rurale
- Mungesa e konsiderueshme e infrastrukturës rurale, në mënyrë të veçantë të furnizimit me ujë, menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin e mbeturinave
- Shërbime të dobëta publike në zonat rurale (kujdesi shëndetësor, transport dhe kopshte)
- Çmimet e larta në tregun e tokës
- Mungesa e bashkëpunimit mes fermerëve, institucioneve publike, sektorit privat dhe publik
- Kufizimet financiare për ndërmarrjen e investimeve në fermë
- Makineri dhe pajisje teknike të vjetruara
- Fermerët konservativë dhe hezitues për të aplikuar teknologji të re
- Niveli i ulët arsimor i fermerëve (shumica vetëm me arsimin fillor)
- Subvencionet shumë të ulëta në krahasim me vendet e tjera të rajonit
- Mungesa e një sistemi të përshtatshëm të kreditimit rural që ofron kredi për fermerët në kushte të mira, me periudha më të gjata dhe normat e ulëta të interesit
- Pasiguri në pronësinë e tokës,
- Progres i pamjaftueshëm përmes programit për konsolidimin e tokës,
- Fermat e vogla dhe toka të fragmentuara cojnë në produktivitet të ulët,
- Mungesa e hapësirave të ruajtjes.

3. METODOLOGJIA DHE TE DHENAT E PERDORURA

Hulumtimido të bazohet në mbledhjen e të dhënave primare dhe sekondare për projektet e zhvillimit rural/grantet në rajonin e Prizrenit. Të dhënat sekondare të mblidhen nga hulumtimet paraprake, nga organizatat kredibile dhe raporte tjera zyrtare të publikuara në këtë fushë. Të dhënat kryesore sekondare do të bazohen në publikimet e KE, BB, MBPZHR, AZHB, Agjencisë të statistikave të Kosovës, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe hulumtimeve të tjera shkencore. Të dhënat primare do mblidhen me anë të pyetësorëve të cilët do të zhvillohen në terren, ku pyetësorët do të hartohen në atë mënyrë që të sigurohen të dhënat sa më të sakta dhe të pasqyrohet gjendja e fermave në rajonin e Prizrenit. Në bazë të këtyre të dhënave të cilat do të merren nga intervistat direkte do të analizohet performanca e tyre socio-ekonomike gjatë kësaj periudhe.

Rëndësi të madhe në këtë hulumtim ka analizimi i të dhënave primare nga pyetësorët duke pasqyruar kështu saktësisht se si kanë ndikuar grantet në zhvillimin ekonomik dhe punësushmëri në rajonin e Prizrenit.

Hulumtimi do të zhvillohet në tri faza:

- A) Faza përgatitore
- B) Faza e hulumtimit në terren (Pyetësorët)
- C) Faza e përpunimit të rezultateve

Faza përgatitore-ka filluar me mbledhjen e të dhënave duke filluar nga literatura, punime shkencore dhe të dhënat statistikore të institucioneve shtetërore dhe të bizneseve. Gjithashtu ka

pasë konsultime me ekspertë të fushës, si dhe zyrtarë të drejtorive komunale për bujqësi, zyrtarë të AZHB-së dhe zyrtarë tjerë relevant.

Faza e hulumtimit- është babazuar në hulumtim i cili është realizuar nga anketimi që është zhvilluar direkt në terren. Anketimi është realizuar me fermerë përfitues dhe jopërfitues të cilët janë përzgjedhur në mënyrë rastërore nga listat e siguruara nga AZHB për masa të caktuara.

Faza e përpunimit të rezultateve- është faza përfundimtare ku janë përpunuar rezultatet e mara nga pyetësorët dhe do janë paraqitur në formën e tabelave dhe grafikeve.

Kjo fazë përbëhet nga tre nën faza:

- Përpunimi dhe analiza
- Interpretimi
- Raportimi

Të dhënat nga këta pyetësorë të realizuar janë përpunuar me programin statistikor SPSS. Rezultatet e fituara tregojnë në veçanti se cili ka qenë ndikimi i granteve në zhvillimin ekonomik dhe punësushmëri në rajonin e Prizrenit.

Pra, për përmbushjen me sukses të objektivave të punimit në ndihmë na kanë dalë të gjitha të dhënat dhe informacionet e mundshme që kemi mundur të i sigurojmë nga të gjithë akterët ofrues të informacionit duke përfshirë këtu të dhëna primare dhe sekondare.

Në ndihmë të punimit jemi shërbyer edhe me të ashtuquajturën “theory of change”, me anë të së cilës neve kemi vendosur si input idenë e aplikimit të granteve në bujqësi dhe kemi parë se si qëllim afatgjatë do të ketë zhvillimin e ekonomisë së vendit, kjo i vjen si rrjedhojë e rezultateve që grantet japin në zhvillim të zonave rurale.

Tabela në vijim (tabela 9), e jep në formë më të konkretizuar impaktin e granteve investive, dhe njëherish një paraqitje e tillë na ka udhëhequr gjatë punës sonë studimore.

Tabela 9. Efekti i granteve

INPUT	OUTPUT	REZULTATET	QËLLIMI
<p><i>Rritja e mbështetjes së fermerëve nëpërmjet politikave bujqësore, saktësisht nëpërmjet rritjes së shumave financiare të granteve investuese.</i></p>	<p>-Fermerët ekzistencial motivohen të rrisin kapacitetet investuese në fermat e tyre duke rritur madhësin e fermës dhe shtuar aktivitetet bujqësore</p> <p>-Fermerët e rinjë po ashtu stimulohen të merren me bujqësi, të shfaqin kreativitetin e tyre duke shfrytëzuar përkrahjen nga fondet e shtetit apo strukturave tjera mbështetëse.</p>	<p>-Rriten fitimet e fermerëve</p> <p>-Rritet rendimenti</p> <p>-Rritet prodhimtaria</p> <p>-Rritet konsumi vendor</p> <p>-Përmirësohet bilanci tregtar</p> <p>-Rritet eksport</p> <p>-Ulet importi</p> <p>-Rritet punësueshmëria në zonat rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve</p> <p>-Përmirësohet standarti i jetës së banorëve në zonat rurale.</p>	<p><i>Rritja ekonomike e vendit duke luftuar krizën ekonomike dhe migrimin e të rinjëve dhe rrjedhimisht pasohet zhvillimi i vendit.</i></p>

Burimi: Autori

4. DISKUTIMI I REZULTATEVE

Ky kapitull do të prezantojë më poshtë rezultatet e marra gjatë studimit të temës duke u mbështetur në të dhëna të sakta, të identifikuar dhe të analizuar me kujdes në detaj.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqit në formë të përmbledhur numri i projekteve të kontraktuara, të ndara sipas masave përkatëse për gjatë viteve 2014-2018.

Tabela 10. Numri i projekteve të kontraktuara sipas masës, 2014-2018

	Programi Vjetor 2014	Programi Vjetor 2015	Programi Vjetor 2016	Programi Vjetor 2017	Programi Vjetor 2018*
Masa 101	238	262	341	325	383
Masa 103	29	31	27	5	27
Masa 302	59	79	97	91	130
Masa 303	12	12	11	-	13
Masa ujitje	-	6	7	1	3
Totali	338	390	483	422	556

2018* Projektet e kontraktuara nuk përfshijnë ato të zbatuara nga projekti i USAID-it Agro për investime në fermat

Burimi: PRZHB 2014-2020

Mbështetur në tablën e 10, duke iu referuar pjesës së totalit, lirshëm shohim se numri i projekteve të kontraktuara gjithmonë ka qenë në rritje e sipër për gjatë këtyre katër viteve të

marra në shqyrtim (2014-2018). Kjo shkon në të mirë të zhvillimit rural pasi që këto projekte dëshmojnë investimet e kryera në ferma.

Masa 101 ka ofruar ndihmë financiare të dizajnuar mirë për një grup të fokusuar të përzgjedhur të fermerëve për investime të bazuara në asetet fizike. Si rezultat, ndryshimi i përgjithshëm i vëzhguar në vlerën e prodhimit ishte shumë më i vogël se sa pritej dhe kur ndryshimet në BVSH, punësim dhe produktivitet u krahasuan me ato të fermave që nuk morën mbështetje, shtimi neto që mund t'i atribuohet mbështetjes ishte marginal në shumë aspekte.

Fermerët kosovarë e shohin masën 101 si një në treg të ndërtesave, pajisjeve dhe makinerive që mund të merren me çmime me zbritje. Atyre u kërkohet të paraqesin planet e biznesit në mënyrë që të kualifikohen për marrjen e grantit, por ata i shohin ato si një ushtrim për mbushjen e formularëve sesa si një plan për transformimin e biznesit të tyre.

Tabela 11. Masa 103 - detajet e thirrjeve vjetore dhe aprovimeve

Masa 103	Aplikimet	Nr. Të kontraktuara	Alokimi i Planifikuar (EUR)	Shuma e kontraktuar (EUR)
2014				
Përpunimi i qumështit	19	12	1,000,000	1,374,203
Përpunimi i mishit	21	11	1,000,000	1,234,948
Përpunimi i pemëve, perimeve	16	12	700,000	1,296,664
Vera	14	8	300,000	249,404
TOTALI	70	43	3,000,000	4,155,220
2015				
Përpunimi i qumështit	13	6	1,400,000	1,005,740
Përpunimi i mishit	26	9	1,400,000	1,604,928
Përpunimi i pemëve, perimeve	38	13	1,400,000	2,244,316
Vera	10	4	800,000	386,675
TOTALI	87	32	5,000,000	5,241,659
2016				
Përpunimi i qumështit	13	4	1,200,000	???
Përpunimi i mishit	27	8	1,400,000	???
Përpunimi i pemëve, perimeve	38	12	1,600,000	???
Vera	6	3	800,000	???
TOTALI	84	27	5,000,000	4,661,782
2017				
Përpunimi i qumështit	20	0	1,000,000	0.00
Përpunimi i mishit	10	0	1,200,000	0.00
Përpunimi i pemëve, perimeve	34	2	2,000,000	398,794

Vera	6	3	800,000	562,230
TOTALI	70	5	5,000,000	961,024

Burimi: PZHRB 2014-2020

Sipas **Masës 103**, dy herë më shumë aplikime janë pranuar se sa ishte buxhetuar, por kishte 33% më pak përfitues të kontraktuar se sa ishte planifikuar. Vetëm në nënsektorin e frutave dhe perimeve është arritur disbursimi i planifikuar monetar. Përderisa Agjencia e Pagesave konfirmon se 85% e investimeve të planifikuara publike janë bërë, raportet e ofruara nuk japin një sasi të mjaftueshme të qartësisë (për shumë nga treguesit) shkallën e ndryshimit të arritur.

Tabela 12. Numri i aplikimeve dhe të miratuara kundrejt objektivit 2014-2017

Sektori	Aplikimet	Projektet e kontraktuara	Targeti	Ndryshimi
Qumësht	65	22	36	-14
Mish	84	28	40	-12
Pemë dhe Perime	126	39	50	-11
Verë	36	18	24	-6
Totali M103	311	107	150	-43

Burimi: PZHRB 2014-2020

Masa 302 siguroi mbështetje shumë të nevojshme për diversifikimin në zonat rurale të Kosovës. Kjo ndihmoi që të krijohen vende të reja pune dhe të ruhen ato ekzistuese, duke zvogëluar kështu migracionin rural-urban, si dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale. Sidoqoftë, sektorët e përzgjedhur për mbështetje nuk ishin optimale dhe nevojat dhe ambiciet e grupeve të synuara u dëshmuuan në disa raste që të ndryshojnë nga supozimet themelore të natyrshme të masës.

Tabela 13. Treguesit e rezultateve të Masa 302

Treguesit	Vlera		Vlera e arritur (kontraktuar)
	PZHRB 2014 – 2020	Planet vjetore '14-'17	
Numri bruto i vendeve të punës të krijuara	515	211	n.a.
Numri i fermave ose ndërmarrjeve që zhvillojnë burime shtesë ose të diversifikuara të të ardhurave	442	165	305

Numri i fermave apo ndërmarrjeve që zgjerojnë aktivitetin e tyre drejt përpunimit në shkallë të vogël	313	117	57
Numri i fermave ose ndërmarrjeve me marketing të përmirësuar	386	144	n.a.
Numri shtesë i turistëve	/	3,285	n.a.

Burimi: PZHRB 2014-2020

Sipas tabelës 11, 305 fermerë dhe ndërmarrje përfituan nga Masa 302, duke zbatuar 321 projekte. Në këtë drejtim, efektiviteti është i lartë, pasi numri i përfituesve të mbështetur është pothuajse dy herë më i lartë se vlera e planifikuar (165). Nga ana tjetër, masa nuk ishte efektive në aspektin e mbështetjes së planifikuar për përpunim në shkallë të vogël: vetëm 57 përfitues të tillë u mbështetën, krahasuar me 165 të planifikuar. Kjo është pasojë e një paragjykimi të fortë ndaj nën-masave të bletarisë gjatë zbatimit.

Zbatimi i **Masës 303** gjeti zbatim jashtëzakonisht të mirë në Kosovë. Puna e bërë nga projektet e mëparshme të AT të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë dypalësh, hartimi cilësor i masave të përfshira në PZHRB 2014-2020 dhe qëndrimi pozitiv i popullatës dhe autoriteteve lokale në zonat rurale ishin të gjitha parakushte për zbatimin shumë premtues të qasjes LEADER të BE-së në vend. E gjithë kjo çoi në zhvillimin cilësor të strategjive të zhvillimit lokal (SZHL) për 12 komuna, krijimin Grupeve lokale të Veprimit (GLV) dhe emërimin e menaxherëve të GLV-ve, shumica prej të cilëve ishin të rinj, të arsimuar mirë, poliglot dhe të motivuar. Të gjitha këto u zhvilluan shumë më herët se në vendet e tjera të Ballkanit, deri në masën që modeli i Kosovës për zbatimin e qasjes LEADER u konsiderua praktika më e mirë midis vendeve të tjera kandidate potenciale të BE. Mjerisht, mungesa e fondeve për dy vitet e para të zbatimit, së bashku me përjashtimin e masës nga çdo plan financiar pasues, ka çuar në zvogëlimin e çdo iniciative dhe humbjen e asaj që ishte bërë dhe arritur.

Tabela 14. Alokimi financiar për Masën 303

Viti	Shuma e alokuar në PZHRB 2014-2017 (EUR)	Shuma e caktuar (EUR)	Racioni i shumës së caktuar për të u ndarë (%)
2014	0	28,161	100%
2015	357,500	76,560	21.41%
2016	375,375	79,850	21.27%
2017	394,144	0	0%

Burimi: PZHRB 2014-2020

Masa kurrë nuk ka marrë një alokim specifik të buxhetit në planet vjetore të PZHRB-së të publikuara nga viti 2015 deri në vitin 2017. Në vitin 2014, MBPZHR ka regjistruar koston prej 28,161 EUR; kjo ishte shuma e alokuar nga buxheti i Ministrisë për kostot që lidhen me ofrimin e asistencës teknike për GLV-të potenciale për përgatitjen e Strategjive Lokale të Zhvillimit. Në vitin 2015, është ndarë një mbështetje e vogël financiare, gjithashtu nga buxheti i Ministrisë, për të financuar krijimin e GLV-ve të përzgjedhura dhe për të mbuluar shpenzimet operative (nën-masa 302.2). Mbështetja financiare u shpërnda në mënyrë të barabartë midis 11 GLV-ve të zgjedhura dhe Rrjetit Kombëtar të tyre (6,380 EUR për secilin GLV dhe rrjetin). Në mënyrë të ngjashme, në vitin 2016 një shtesë e vogël financiare u është caktuar GLV-ve. Kjo është shpërndarë sipas skemës së mëposhtme: 9,000 EUR për GLV-të me përmasa të mëdha dhe Rrjetin Kombëtar, 7,000 EUR për LAG-të e mesme dhe 5,000 EUR për GLV-të e vogla. Madhësia është llogaritur sipas popullsisë së mbuluar nga GLV-të.

Masa 401 është projektuar për të mbështetur ofrimin e trajnimeve profesionale për të trajtuar boshllëqet e identifikuar në informacion, njohuri dhe inovacion midis të dy palëve fermerëve dhe ekonomisë më të gjerë rurale. Nevojat e tyre përfshijnë më së shumti modernizimin e sistemeve të prodhimit të fermave për sisteme agro-ushqimore më konkurruese, përmirësimin e kapaciteteve për diversifikimin e biznesit, rritjen e të ardhurave, krijimin e vendeve të punës dhe nxitjen e zhvillimit shoqëror më të gjerë në zonat rurale.

Masa 401 lidhet me **Masën 402** e cila është projektuar për të mbështetur ofrimin e shërbimeve këshillimore. Në fund të fundit, këto masa nuk u zbatuan, me arsyt e dhëna si kapacitete të pamjaftueshme brenda organeve publike (komunat, agjencitë publike) dhe OJQ-të, prioritizimi i masave të tjera brenda një buxheti të kufizuar dhe disa pengesa ligjore.

Masa Ujitja e tokës bujqësore u zbatua fillimisht si një masë kombëtare dhe u përfshi në PZHR në 2015. Ujitja e tokës bujqësore është vendimtare për të përmirësuar aftësinë konkurruese të sektorit bujqësor dhe ngritur të ardhurat e fermerëve dhe banorëve në zonat rurale të Kosovës për shkak të mungesës së përgjithshme të ujit për ujitje të kombinuar me verëra të nxehta dhe të thata.

Tabela 15. Shpërndarja gjeografike e projekteve të mbështetura sipas komunave

Nr.	Komuna	Numri i projekteve				
		Viti				Total
		2014	2015	2016	2017	
1	Junik	1	2			3

2	Deçan	1				1
3	Istog	1		3		4
4	Pejë	1	2			3
5	Vushtrri	1				1
6	Prizren	1		1		2
7	Klinë		1	1		2
8	Rahovec		1			1
9	Malishevë			2		2
10	Viti				1	1
	Totali për vit	6	6	7	1	20

Burimi: PZHRB, 2014-2020

Sektori i bujqësisë si aktivitet ekonomik shumë i rëndësishëm dhe strategjik për vendin tonë merr pjesë me **9%** të Bruto Produktit Vendor. Ndërsa në raport me gjithsej numrin e të punësuarve bujqësia merr pjesë me rreth **25%**, ku në këtë sektorë punojnë 362,700 persona (MBPZHR , 2018).

Ministria e Bujqësisë, viteve të fundit ka përkrahur sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural me subvencione dhe grante investive. Këto investime të ministrisë, përmes Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2019 janë planifikuar të jenë në vlerë prej 25,7 milionë euro, ndërsa investimet e ministrisë përmes pagesave direkte planifikohen të jenë rreth 25 milionë euro (MBPZHR, 2018).

Nga viti në vit është rritur numri i përfituesve të granteve investive, duke treguar se nga 403 përfitues sa ishte në vitin 2014, ky numër në vitin 2018 ka arritur në mbi 600 përfitues, gjë që dëshmon rritjen e mbështetjes së ministrisë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë(MBPZHR, 2018).

Përkundër rritjes së Produktit Vendor Bruto (BPV) prej 4% në 3 vitet 2015-2017, Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajonin e Ballkanit. PBB për frymë ishte rreth 3,200 euro në vitin 2017. Ekonomia tregon pabarazitë e jashtme, me një deficit tregtar shumë të lartë prej 30% të PBB-së në vitin 2016 dhe një deficit të lartë të llogarisë korente prej rreth 9.1% të BPB-së, e cila vetëm pjesërisht zbutet nga shumë të larta fluksi i remitancave (759 milionë euro ose 12% të BPB-së në vitin 2017). Investimet e Huaja Direkte (IHD) arrijnë në 5.6% të BPB-së, por pothuajse 60% e të gjitha IHD-ve hyjnë në pasuri të paluajtshme dhe vetëm 7.1% fokusohen në sektorin e prodhimit, duke reflektuar një mjedis të dobët biznesi.

Vetëm 30% e popullsisë është në punësim, dhe 23% e tyre janë punonjës të sektorit publik. Paga mesatare neto në sektorin publik në 2017 ishte 452 euro në muaj. Shkalla e papunësisë në Kosovë, më e larta në Evropë, u rrit në 30.5% në 2017 (nga 27.5% në vitin 2016). Vetëm 20% e grave marrin pjesë në tregun e punës dhe 38% e tyre janë të papunë për 9 muajt e parë të vitit 2017. Papunësia e lartë e të rinjve (51.6%) tregon një mosbarazim të qartë ndërmjet sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës.

Treguesit kryesorë për matjen e efekteve të granteve të investimeve të PZHRB-së janë: i) Vlera e Shtuar Bruto (VSHB); dhe ii) Njësia Vjetore e Punës (NJVP). Këto maten para dhe dy vjet pas, përfundimit të investimit të dhënë ndaj një grupi kontrolli të bizneseve të krahasueshme që nuk kanë marrë ndihmë përmes masave të PZHRB.

Bazuar në të dhënat e mbledhura, ekspertët llogarisin statistikat përshkruese (Shuma, Mesatarja, Devijimi Standard, Min, Max) dhe indekset e ndryshimit (nga 2015 në 2017) për të gjithë variablat. Duke qenë se pyetësorët u hartuan për të qenë sa më miqësorë, ekipi duhej të llogariste VSHB në një mënyrë që nuk përputhet me përkufizimin e saktë të masës (edhe pse rezultati duhet të jetë i ngjashëm): Llogaritja e përdorur ishte ose: gjithsej vlera e prodhimit të fermës - kostoja totale e prodhimit të fermës, ose, në rastin e FADN: ferma bruto Të ardhurat + konsumi total i ndërmjetëm. Rezultatet mund të shihen në Tabelën e më poshtme.

Tabela 16. Rezultatet kryesore të llogaritjeve bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të dhënave FADN

Masa	Tipi	Numri	Ndryshimi	Ndryshimi	Ndryshimi
			VSHB	NJVP	VSHB/NJVP
			%	%	%
M101 QUMËSHT	Përfituesit	18	116.7%	100.5%	116.2%
M101 PERIME	Përfituesit	10	176.0%	142.5%	123.5%
M101 MISH	Përfituesit	10	113.8%	101.5%	112.1%
M101 PEMË	Përfituesit	12	172.9%	80.7%	214.2%
M101 TOTALI	Përfituesit	50	132%	101.3%	130.2%
FADN qumësht	Jo-përfituesit	360	124.9%	107.5%	116.2%
FADN perime	Jo-përfituesit	37	105.2%	101.4%	103.7%
FADN mish	Jo-përfituesit	332	113.6%	105.7%	107.4%
FADN pemë	Jo-përfituesit	76	123.3%	88.6%	139.2%
FADN të tjera	Jo-përfituesit	302	116.9%	114.3%	102.3%
FADN Total	Jo-përfituesit	1107	119.2%	106.5%	112.0%
M103	Përfituesit	9	179.2%	115.2%	155.5%

NB M103	Jo-përfituesit	14	152.3%	129.9%	117.2%
---------	----------------	----	--------	--------	--------

Burimi PZHRB 2014-2020

Rezultatet e tabelës 11, tregojnë se në përgjithësi, fermat përfituese kanë performuar pak më mirë se sa grupi i kontrollit, në të dy termat VSHB dhe VSHB / NJVP. Ndërsa ky ishte rasti me të dyja masat 101 dhe 103, ajo nuk zbatohet për të gjithë sektorët dhe është e habitshme të theksohet se ndryshimi në NJVP ishte totalisht më i lartë në grupin e kontrollit. Megjithatë, produktiviteti i punës së përfituesve u rrit shumë më fort sesa ai i grupit të kontrollit.

Sa i përket eksportit- Eksporti i produkteve bujqësore në vitin 2017, ka arritur vlerën më të lartë deri më tani (61.3 mil. €), që krahasuar me vitin 2016 eksporti ka pasur një rritje prej 35.5%, ndërsa importi ka pasur vlerë prej 694.5 mil. €, duke shënuar rritje për 5.4% krahasuar me vitin 2016. Nga të dhënat paraprahe del se edhe gjatë vitit 2017 kemi deficit tregtar në vlerë prej -633.1 mil. €. Partnerët kryesor tregtar me të cilët Kosova realizoi vlerën më të lartë të eksportit dhe importit janë vendet e rajonit, anëtare të marrëveshjes së tregtisë së lirë-CEFTA.

5. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

5.1 Konkluzionet

Rendimetet afatgjata të kulturave në Kosovë shpiejnë në konkludim se produktiviteti i shumicës së kulturave është mbi 50 përqind me i ulët nga niveli optimal. Kështu ndodh për shkak të praktikave tradicionale të marrjes me ferma siç janë: shkalla e lartë e mbjelljes së farërave, aplikimi i variacioneve me rendimente më të ulëta, aplikimi i llojeve të plehërave kimike me pakë produktive apo mospërdorimi i herbicideve dhe praktikat jo aq efikase të menaxhimit të fermave (R. Andersson, L. Hedquist, I. Kvist., 2001).

Qeveria e Kosovës ka treguar përkushtimin e saj për krijimin e parimeve të ekonomisë së qëndrueshme të tregut. Përcaktimi i vendosur për të mbështetur fermerët përmes skemave të qëndrueshme financiare, pasqyron qartë këtë përkushtim. Fermerët të përfshirë brenda skemave si përfitues tashmë gëzojnë një mbështetje, e cila do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, duke bërë të mundur që fermerët kosovarë të hyjnë në një treg konkurrues më të përgatitur dhe të organizuar. Përkrahja direkte e fermerëve tregon se Qeveria e Kosovës ka filluar punën për ndërtimin e mekanizmave për të adresuar sfidat e fermerëve në Kosovë.

Prandaj, mbështetja direkte e fermerëve kosovarë ndihmon rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në tregun lokal dhe regional. Pavarësisht, se efektet e këtij aktiviteti janë ende të limituara në rendimentin e fermerëve, nga viti në vit rezultatet janë më të dukshme. Kjo i arsyeton veprimet e qeverisë nga se fermerët përfitues të ndihmës janë duke u përafuar me rendimentet që i arrijnë fermerët në rajon, brenda kulturës së njëjtë.

Pasi Kosova ka kushte të favorshme natyrore për kultivimin e shumë kulturave bujqësore, shtohet si domosdoshmëri vazhdimi i konsolidimit të fermerëve, me qëllim të rritjes së mëtejshme të rendimentit. Për më tepër, ata kanë nevojë krahas rritjes së rendimentit, për rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së tyre si fermerë, në mënyrë që të konkurrojnë në mënyrë efektive me prodhuesit e këtyre kulturave në rajon dhe më gjerë. Për të rritur më tej rendimentin e kulturave, fermerët duhet të përmirësojnë procesin e menaxhimit të fermës, duke kursyer shpenzimet në fermë.

Për më tepër, për shkak të konkurrencës në rritje, fermerët e Kosovës do të jenë të detyruar që të jenë më inovativ në përdorimin e teknologjive më të sofistikuara. Së fundi, ndihma direkte e fermerëve në Kosovë siguron të paktën dy përfitime të konsiderueshme të tilla si: ***rritjen e kapacitetit financiar dhe menaxherial të fermës si dhe një konkurrueshmeri në rritje me fermerët e vendeve të rajonit***(Gjokaj, E. Veliu, N. Gjonbalaj, M., 2012).

5.2 Rekomandimet

Kosova ka vështirësi të theksuara konkurrencte në tregun e produkteve e aq më tepër në eksport që kjo vjen si rrjedhojë e resurseve dhe mundësive objektive të kufizuara të fermerëve tanë, prandaj mbështetur në këtë shihet si shumë e arsyeshme ristrukturimi i prodhimit bujqësorë.

Në anën tjetër mundësia që aftësia konkurruese të mbrohet përmes subvencioneve dhe tarifave më të larta është e kufizuar si koncept, kjo për shkak të mundësive të vogla për investime dhe të rregullave të tregtisë së lirë.

Bujqësia e Kosovës karakterizohet akoma me metoda shumë tradicionale të prodhimit duke ofruar rendimente të ulëta, karakter të theksuar sezonal dhe vështirësi të tjera, mu për këtë arsye duhet gjetur forma më efikase të komunikimit me fermerë, më mënyrë të atillë, që të arriturat më moderne të teknologjisë së prodhimit bujqësorë të arrijnë të i zotërojnë dhe të i aplikojnë në fermat e tyre.

Gjithashtu formimi dhe anëtarësimi i fermerëve nëpër shoqata do t'iu mundësonte atyre inormimin më të plotë duke shfrytëzuar çdo lloj beneficioni që mund të kenë me rastin e inkuadrimit.

Bazuar në kushtet natyrore, traditën dhe mundësitë e ndërtimit të konkurrencës, është shumë e rëndësishme të zgjidhen sektorët të cilët do të kenë përparësi në këtë pikë, siç janë: blegtoaria (prodhimi dhe përpunimi i mishit dhe qumështit), pastaj bimët për ushqimin e kafshëve dhe sigurisht sektori i pemëve dhe perimeve. Këta sektorë na shfaqen si të rëndësishëm për dy arsye: në rend të parë për substituimin e importit pasi që sasi të mëdha të tyre importohen nga vendet e ndërkombëtare dhe e dyta për shkak se disponojmë resurse shumë të favorshme natyrore për avansimin e prodhimit në këta sektorë.

Krijimi i një ambienti më të përshtatshëm për stimulimin e fermerëve, kreditimi me kushte të favorshme, ngritja profesionale e fermerëve, do të ishin vetëm disa nga masat që do të ndikonin në rritjen e prodhimit në këta sektorë. Nëpërmjet një programi të masave konzistente, që përfshijnë sidomos asistencën teknike dhe financiare, nevojitet që këta sektorë të stimulohen në zhvillimin e tyre, duke pasur parasysh edhe industrinë përpunuese ushimore.

Një formë e preferuar e mbështetjes financiare do të ishte dhënia e kredive për prodhuesit dhe përpunuesit bujqësorë, duke subvencionuar normën e interesit të kredisë. Kjo nënkupton që vendimi për dhënie të kredive dhe zgjedhja e përfituesve të mbetet përgjegjësi e bankës. Shembuj të tillë kemi disa shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore, ku huamarrësit paguajnë një të tretën e kamatës së bankës private, ndërsa dy të tretat e kamatës, bankës i kompensohet nga buxheti i qeverisë. Ky program në shumë shtete është treguar shumë i suksesshëm.

Duhet parë si mundësi zhvillimi duke ofruar mbështetje financiare edhe aspektit të ndërmarrësisë dhe zhvillimit të bizneseve jobujqësore, pra, bizneseve familjare komplementare. Përkrahje për biznese me perspektivë siç ato të përpunimit të drurit, përpunimit të produkteve bujqësore, bletaria, bimët mjekësore dhe me më shumë rëndësi turizmit fshatarë. Të gjitha këto janë në tendencat fillestare të zhvillimit dhe mund të

konsiderohet lirshëm se këtu janë hapësirat më të mëdha për ndryshime, si të gjenerimit të punësimit ashtu edhe të të ardhurave në viset rurale. Faktorë relevantë në mbështetjen e këtyre bizneseve është ndërtimi i kapaciteteve institucionale në pushtetin vendës, komunitetet, organizatat e shoqërisë civile, shërbimet financiare rurale etj.

Të rishiqohen vazhdimisht strategjitë egzistuese sektoriale që kanë ndikim në bujqësi pas një analize të mirfilltë sektoriale në raport me potencialet dhe resurset e zonave rurale.

Institucionet lokale dhe qendrore duhet të inkurajojnë edhe më tutje investimet në infrastrukturën themelore në viset rurale për t'i bërë ato pjesë më tërheqëse e atraktive për investime të mëtejme në themelimin e bizneseve të reja si rrugë më e sigurtë për zhvillimin ekonomik të regjionit dhe uljen apo zbutjen e papunësisë si dukuri shumë e theksuar edhe në këtë regjion.

Në periudhën afatshkurtër (2019-2020), PZHR duhet të marrë në konsideratë ofrimin e trajnimit të trajnerit (TiT), të ofruar nga një ekip ndërkombëtar me përvojë me burime materiale, tek një grup këshilltarësh të Kosovës të zgjedhur nëpërmjet një procesi të fuqishëm përzgjedhës. Trajnimi do të përqendrohet në temat kryesore në nën-sektorët prioritarë bujqësorë dhe diversifikimin e biznesit. Qëllimi do të ishte krijimi i një ekipi këshillues të ekspertëve të Kosovës që ka të drejtë të ofrojë paketa këshillash për aplikuesit e suksesshëm të PZHR për masa specifike. Duhet të krijohen sisteme monitorimi për të matur inputet, outputet dhe rezultatet e ofrimit të shërbimeve.

Meqenëse fermerët kosovarë kanë tendencë të mos hezitojnë të bashkëpunojnë për të promovuar iniciativa të përbashkëta, ekziston nevoja për aktivitete ndërgjegjësuese për të shpjeguar mundësinë për menaxhimin e përbashkët të burimeve ujore dhe sistemeve të ujitjes. Këto fushata do të mbulonin: **i)** përmirësimin e planeve ekzistuese të përdorimit të ujit; **ii)** vetëdijësimin e teknologjive në dispozicion; **iii)** menaxhimin e përbashkët të sistemit të ujitjes; dhe **iv)** të kuptuarit e fermerëve për të drejtat dhe tarifat e ujit, si dhe procedurat e përfshira në marrjen e lejeve. Mbështetja e ardhshme për ujitje duhet gjithashtu të sjellë përmirësimin e matjeve dhe pagesave për përdorimin e ujit, me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe menaxhimin e sistemeve.

Literatura

- Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2019). *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës*. Prishtinë: ASK.
- AKMM. (2008). *Raport i Gjendjes së Mjedisit 2006-2007*. Prishtinë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Andersson, R. Hedquist, L. Kvist, I. (2001). *Statistikat e Bujqësisë në Kosovë*. Prishtinë: SIDA.
- ASK. (2011). *Regjistrimi i Popullsisë*. Prishtinë: Agjencioni i Statistikave të Kosovës.
- ASK. (2018). *Anketa e Ekonomive Bujqësore*. Prishtinë: Agjencioni i Statistikave të Kosovës.
- Cantore, N. Kennan, J. Page, Sh. (2011). *CAP reform and development*. Brussels: Overseas Development Institute.
- Costa, C. Osborne, M. Zhang, C. et, Al. (2009, Dhjetor). *Australian Government Productivity Commission*. Retrieved from Modelling the Effects of the EU Common Agricultural Policy: <https://www.pc.gov.au/research/supporting/european-agricultural-policy/european-agricultural-policy.pdf>
- Daci, E. (2016, Prill). *Impact of Agricultural Policy in Development of Agriculture Sector Within the Period of 1999-2015 in Kosovo*. Retrieved from Research Gate: https://www.researchgate.net/publication/318535119_Impact_of_Agricultural_Policy_in_Development_of_Agriculture_Sector_Within_the_Period_of_1999-2015_in_Kosovo
- DG Agriculture and Rural Development. (2013). *Overview of CAP Reform 2014-2020*. European Commission.
- Gjergjizi, H. (n.d.). *Politikat Bujqësore dhe Tregu i Ushqimit*. Prishtinë.
- Gjokaj, E. et, Al. (2016). *Analiza e politikave për zhvillimin rural dhe bujqësorë të shteteve të Ballkanit Perëndimor*. Luksemburg: European Commission.
- Gjokaj, E. Veliu, N. Gjonbalaj, M. (2012). Grantet dhe Subvencionet për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Kosovë. *Revistë shkencore e Institutit Alb-Shkenca*, 435-442.

- International Center for Soil Fertility . (2006, Janar). *Restoring Kosovo's Agriculture Sector After Conflict-IFDC's Involvement*. Retrieved from Amazona: <https://www.amazon.ca/Restoring-Kosovos-Agriculture-Conflict-Ifdcs-Involvement/dp/0880901519>
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. (2019, Mars). *Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale*. Retrieved from <https://kosovo-mining.org/kosova/gjeografia/>
- MASHT. MBPZHR. (2004). *Strategjia Afatmesme e Arsimit për Popullsinë Rurale në Kosovë*. Prishtinë: FAO.
- MBPZHR . (2018). *Raporti i Gjellbër 2018*. Prishtinë: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- MBPZHR. (2017). *Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural*. Prishtinë: Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- MBPZHR. (2018, Dhjetorë 18). Retrieved from Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: <https://www.mbpzhr-ks.net>
- Mussi. S, Hegarty. M, Vago. S, et(al). (2019). *Rural Development Programme*. Prishtinë: Office of the European Union to Kosovo.
- Raport. (2010). *Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2010-2013*. Prishtinë: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Skreli, E. (2006). *Politikat e Bujqësisë dhe të Ushqimit*. Tiranë.
- The World Bank. (2016). Retrieved from <http://documents.worldbank.org/curated/en/home>
- Zobbe, H. (2001). *The Economic and Historical Foundation of the Common Agricultural Policy in Europe*. Copenhagen: The Royal Veterinary and Agricultural University.
- Zymeri, S. Thaqi, F. Hoxha, A. (2019). *Procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë*. Prishtinë: Zyra Kombëtare e Auditimit.
- (2004). *Zhvillimi Rural në Kosovë*. Prishtinë: RIINVEST.

